


**RAPORTI I MONITORIMIT
TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SIGURIMIT
TË TRANSPARENCËS
DHE PROCESIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK NGA BASHKITË**



**RAPORTI I MONITORIMIT
TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SIGURIMIT
TË TRANSPARENCËS DHE
PROCESIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK NGA BASHKITË**



Përmbajtja

HYRJE	5	Bashkia Vlorë	20
RAPORTI 2024.....	6	Bashkia Elbasan.....	21
TRANSPARENCA	6	ANALIZË KRAHASUESE	23
METODOLOGJIA	6	MBAJTJA E PREMTIMEVE	24
PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR.....	7	ANALIZË KRAHASUESE (5 VJEÇARE)	31
GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE.....	9	MBAJTJA E PREMTIMEVE	31
Bashkia Durrës.....	9	INDEKSI I TRANSPARENCËS	36
Bashkia Dibër.....	10	FONDI SOCIAL.....	42
Bashkia Shkodër	11	PËRFITUESIT E FONDIT SOCIAL	42
Bashkia Sarandë	13	PERFORMANCA E BASHKIVE	42
Bashkia Lezhë.....	14	GJETJE DHE REKOMANDIME	43
Bashkia Korçë.....	16	ANALIZA E FINANCIMIT PËR FONDIN SOCIAL 2023-2024	44
Bashkia Fier	17	VLERA E FINANCIMIT PËR FONDIN SOCIAL	47
Bashkia Kavajë.....	18		

Lista e tabelave

Tabela 1 - Indeksi i Transparencës sipas viteve për çdo bashki	36
Tabela 2 - Shërbimet e ofruar në vitin 2024 nga bashki të ndryshme në vend	49
Tabela 3 - Kategoritë e shtresave vulnerabël të identifikuara në bashki që mund të përfitojnë nga shërbimet sociale.....	52

Lista e figurave

Figura 1 - Paraqitje grafike e numrit të premtimeve të verifikuara.....	33
Figura 2 - Indeksi i Transparencës sipas viteve për çdo bashki	37
Figura 3 - Indeksi i Transparencës Bashkia Shkodër	37
Figura 4 - Indeksi i Transparencës Bashkia Lezhë.....	38
Figura 5 - Indeksi i Transparencës Bashkia Korçë	39
Figura 6 - Indeksi i Transparencës Bashkia Vlorë	39
Figura 7 - Indeksi i Transparencës Bashkia Fier	40
Figura 8 - Indeksi i Transparencës Bashkia Elbasan.....	40
Figura 9 - Indeksi i Transparencës Bashkia Durrës.....	41
Figura 10 - Vlera totale per Fondin Social 2023-2024.....	44
Figura 11 - Shërbime total për vitin 2023 & 2024 (bashki përfituese)	47
Figura 12 - Vlera e financuar për 10 bashkitë në monitorim për vitin 2023 & 2024	48

HYRJE

Projekti "40 premtime, 10 bashki" është i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe është implementuar nga Qendra Faktoje. Synimi i këtij projekti është monitorimi i bashkive sa i përket mbajtjes së premtimeve dhe transparencës. Gjatë vitit të shkuar projekti përfshiu bashkitë e Dibrës, Elbasanit, Fierit, Kavajës, Durrësit, Korçës, Lezhës, Shkodrës, Vlorës dhe Himarës të cilat u monitoruan nga gazetarë lokalë si edhe aktivistë të shoqërisë civile.

Metodologjia e ndjekur për implementimin e këtij projekti është e njëjtë me metodologjinë e përdorur gjatë vitit të shkuar. Për secilën nga bashkitë janë përzgjedhur 4 premtime të bëra nga kryebashkiakët aktualë gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendore 2023. Këto premtime u monitoruan në bazë të një metodologjie analitike që përfshinte analizën buxhetore, monitorimin e prokurimit publik dhe vëzhgimet në terren. Gjithashtu raporti ka monitoruar edhe programin e transparencës, detyrim ligjor i Bashkive që rrjedh nga legjislacioni i qeverisjes vendore, legjislacioni i konsultimit publik dhe ligji për të drejtën e Informimit. Nga ana tjetër, transparenca dhe konsultimi publik janë të rregulluara nga kuadri ligjor dhe nënligjor i Shqipërisë. Duke qenë se në bazë

të legjislacionit vendas, çdo institucion publik duhet të zbatojë programin e transparencës, projekti ka monitoruar se sa ky program zbatohet nga bashkitë e përfshira në projekt.

Ky raport i rifreskuar synon që të përcjellë të dhëna lidhur me monitorimin e zbatimit të këtyre parashikimeve nga dhjetë bashki të vendit. Në raport do të gjeni metodologjinë e përdorur, gjetjet e detajuara të secilës prej bashkive dhe disa rekomandime për përmirësimin sa i përket llogaridhënies dhe zbatimit të parashikimeve ligjore në lidhje me transparencën.

Ky raport ndahet në tre kapituj. Kapitulli i parë lidhet me indeksin e transparencës. Kapitulli i dytë me mbajtjen e premtimeve nga ana e kryetarëve të bashkive kurse kapitulli i tretë lidhet me rëndësinë e Fondit Social si mekanizëm për të fuqizuar bashkitë dhe me problematikat që hasen në përthithjen e fondeve.

Duke qenë se ky raport hartohet për të pestin vitin radhazi, në brendësi të tij paraqitet një analizë krahasimore për indeksin e transparencës dhe premtimet për secilën nga Bashkitë që kanë qenë pjesë e monitorimit.

RAPORTI 2024

TRANSPARENCA

METODOLOGJIA


Detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës janë identifikuar nëpërmjet analizës së kuadrit ligjor përkatës. Organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes vendore është i rregulluar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndërsa detyrimet e tyre për procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës rregullohen më tej nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, siguron disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike, dhe parashikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.

Normativa ligjore përsa i përket transparencës në njësitë e pushtetit vendor është plotësuar më tej me Urdhërin nr. 211, dt. 20.09.2018, të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ku përcaktohet “Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, duke detajuar më tej detyrimet e organeve të pushtetit vendor për të siguruar transparencë dhe informim të publikut. Nga parashikimet e këtyre tre ligjeve janë gjeneruar edhe 16 indikatorët për të cilat janë monitoruar dhjetë bashkitë e vendit:

- **INDIKATORI 1:** Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për

garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;

- **INDIKATORI 2:** Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 3:** Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore;
- **INDIKATORI 4:** Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë;
- **INDIKATORI 5:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 6:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të Bashkisë;
- **INDIKATORI 7:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 8:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 9:** Përcaktimi dhe publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- **INDIKATORI 10:** Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë;
- **INDIKATORI 11:** Publikimi i strukturës organizative të bashkisë;



- **INDIKATORI 12:** Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 13:** Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- **INDIKATORI 14:** Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak;
- **INDIKATORI 15:** Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë;
- **INDIKATORI 16:** Publikimi në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike i raporteve të zbatimit të buxhetit.

Të dhënat e këtij raporti për monitorimin e 16 indikatorëve janë mbledhur nga gazetarët në terren. Gazetarët zhvilluan paraprakisht takime informuese me ekspertët të cilët punuan me identifikimin e indikatorëve dhe ekspertin ligjor, për t'u informuar dhe për të marrë shpjegimet përkatëse për të gjithë indikatorët, bazën ligjore të tyre dhe mënyrën e monitorimit. Pas këtij procesi informues dhe sqarues me gazetarët, këta të fundit duke pasur informacionin e duhur mbi indikatorët, mbi parashikimet ligjore të detyrimeve të bashkive për realizimin e tyre dhe burimet nga mund të merrnin informacion për secilin prej tyre, kanë analizuar faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe kanë monitoruar stendat e njoftimeve publike të bashkive, si një mënyrë tjetër alternative që përdorin bashkitë për komunikimin me qytetarët. Gjithashtu gazetarët kanë ndjekur drejtëpërdrejtë mbledhjet e këshillit bashkiak, fizikisht dhe/ose online sipas rasteve përkatëse. Një burim tjetër i përdorur nga gazetarët për mbledhjen e të dhënave është komunikimi i drejtëpërdrejtë me bashkinë, duke kërkuar informacion.

Përveç këtij monitorimi të gazetarëve, bashkive të monitoruara i është dërguar shkresë zyrtare duke i kërkuar informacionin dhe dokumentacionin

përkatës për indikatorët e mësipërm të cilat lidhen me konsultimin e akteve të miratuara dhe njoftimet që duhet të realizohen në kuadër të zhvillimit të konsultimit publik për to. Për të bërë një renditje të bashkive të përfshira në projekt sa i përket transparencës, për secilin nga indikatorët e sipër-përmendur bashkive u është alokuar nga 1 pikë për një total prej 16 pikësh për bashkitë që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore.

PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR

Indikatorët e monitoruar për dhjetë bashkitë e vendit janë gjeneruar nga parashikimet ligjore përkatëse të cilat rregullojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, procesin e konsultimit publik dhe transparencën. Konkretisht janë Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".


Ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" rregullon procesin e konsultimit publik, për të siguruar transparencën, gjithëpërfshirjen dhe realizimin në kohë të veprimeve. Ky konsultim publik, për të siguruar përfshirjen në procesin e vendimmarrjes zhvillohet për projektakte si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatimi i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;¹
- Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë²

¹ "Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuara nga ky ligj", Neni 10, ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

² "Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik", Neni 1, ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Detyrimi për këtë këshillim e konsultim buron edhe nga parashikimet e ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht nenet 18 dhe 54 të këtij ligji.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore³
 - Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë⁴
 - Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁵
 - Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁶
 - Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁷
 - Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁸
- Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatimi i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:
- Përcaktimi dhe publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit⁹
 - Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë¹⁰
 - Publikimi i strukturës organizative të bashkisë¹¹
 - Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë¹²
 - Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak¹³
 - Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak¹⁴
 - Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë¹⁵

³ Po aty.

⁴ Po aty.

⁵ “Njoftimi për projektaktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrimit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar. 2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike”. Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

⁶ Po aty.

⁷ “Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes”, neni 17, ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Përveç parashikimit në këtë ligj, dy indikatorët e fundit janë analizuar edhe në këndvështrimin e zhvillimit të konsultimit publik, ku nëpërmjet mbledhjeve të këshillit bashkiak e komisioneve, bashkia këshillohet me qytetarët.

⁸ Neni 54 i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon se Këshilli bashkiak zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet. Komisioni si një nga strukturat e këshillit bashkiak ka të njëjtat detyrime kundrejt qytetarëve të njësisë, për më tepër që këshilli bashkiak ka për detyrë këshillimin me bashkësinë për krijimin e këtyre komisioneve sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 54/a të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

⁹ “Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit”, Neni 10, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

¹⁰ “Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstet e plota... të akteve nënligjore; e) të dhëna për buxhetin”, Neni 7, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ Po aty. Zbatimi i parashikimeve të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” referohet për detyrimin e publikimit të akteve të këshillit bashkiak drejtpërdrejtë nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 18. Në këtë nen parashikohet gjithashtu se aktet e këshillit bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike.

¹⁴ Po aty.


¹⁵ Po aty.

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE (INDIKATORËT E TRANSPARENCËS)

Për secilën nga bashkitë e përzgjedhura janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet për çdo indikator janë listuar si më poshtë:

BASHKIA DURRËS

Nr	Indikator	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Durrës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit nuk paraqitet asnjë njoftim i tillë.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga përgjigja zyrtare e Bashkisë, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Sa i përket paketës së taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024 ato janë konsultuar me publikun njëkohësisht me buxhetin vjetor 2024 të Bashkisë Durrës. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj se nuk ka mbajtur konsultime publike, pasi për periudhën Janar 2024 - Dhjetor 2024 nuk është bërë asnjë procedurë për tjetërsim të pronave të Bashkisë Durrës.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE


12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Durrës ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		93.75%

BASHKIA DIBËR

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinitorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinitorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Dibër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	



8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Sa i përket paketës së taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024 ato janë konsultuar me publikun njëkohësisht me buxhetin vjetor 2023, 2024 të Bashkisë Dibër.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Sa i përket tjetërsimit të pronave, Bashkia Dibër nuk ka mbajtur konsultime publike, pasi për periudhën Janar 2024 - Dhjetor 2024 nuk është bërë asnjë procedurë për tjetërsim të pronave të Bashkisë Dibër.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Dibër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Këshilli Bashkiak, ne cdo mbledhje të tij ka bërë njoftimet ku është treguar data dhe ora për cdo mbledhje të zhvilluar. Njoftimet janë publikuar në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak si dhe web, Dibër, Këshilli Bashkiak ,Njoftime Publike.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka bërë njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak, së bashku me rendin e ditës, ku tregohet data dhe ora e mbledhjes së Komisioneve të Përhershme	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Dibër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Dibër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Dibër ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		93.75%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA SHKODËR


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinatorit.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka plotësuar këtë kërkesë ligjore.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendë, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	



16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Shkodër ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA SARANDË

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor deri në vitin 2022, prandaj ky indikator nuk konsiderohet i realizuar.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Sarandë e ka përmbushur këtë detyrim.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka përmbushur këtë detyrim.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE


12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Sarandë nuk ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		87.5%

BASHKIA LEZHË

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	



7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga standat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i standave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Lezhë i ka konsultuar me qytetarët vendimet për tjetërsimin e pronave të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i standave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në standat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në standat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Lezhë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA KORÇË


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Korçë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Korçë nuk ka të publikuar asnjë njoftim për konsultim publik për tjetërsimin e pronave.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Korçë nuk e ka realizuar këtë detyrim. Në website e Bashkisë, të fundit të publikuara janë urdhërat e Kryetarit të vitit 2019.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	



15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Korçë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		87.5%

BASHKIA FIER

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinitorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e konsultimeve publike për paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e konsultimeve publike për tjetërsimin e pronave.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE


11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Fier nuk ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		43.75%

BASHKIA KAVAJË

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	



7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka vendosur në stendat e njoftimeve njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Kavajë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		50%




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA VLORË


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Vlorë nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Vlorë nuk e ka konsultuar me qytetarët vendimin për tjetërsimin e pronave.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Vlorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka të publikuar njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	



15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Vlorë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		62.5%

BASHKIA ELBASAN

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan nuk ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Elbasan nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar këtë detyrim. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësave publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Elbasan ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		50%

ANALIZË KRAHASUESE

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur rezultatet e monitorimit për të dhjetë bashkitë e monitoruara, të renditura sipas rezultatit në indeksin e transparencës. Vlen të theksohet se për bashkitë Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë, Elbasan, Fier, Dibër, Durrës dhe Kavajë të cilat u monitoruan dhe vitin e kaluar, vetëm Bashkitë Shkodër dhe Lezhë ruajnë të njëjtin nivel transparence si vitin e kaluar duke përmbushur 100% të indikatorëve. Bashkitë Durrës, Dibër dhe Kavajë paraqesin rritje në përqindje të indeksit të tyre të transparencës. Të gjitha bashkitë e tjera (Korça, Vlora, Elbasani, Fieri) nuk kanë ruajtur dot nivelin e transparencës së vitit të kaluar, përkundrazi kanë shënuar rënie.

Pas vendit të parë me nivelin më të lartë të transparencës, që e mban Bashkia Shkodër dhe ajo e Lezhës ndodhen 2 bashki të tjera të cilat përmbushin 15 nga 16 indikatorët, specifiku Bashkia Dibër dhe Durrës. Më pas në renditje gjenden Bashkia e Korçës dhe e Sarandës të dyja me të njëjtin nivel transparence në masën 87.5% duke realizuar 14 nga 16 indikatorët e matur. Bashkia Vlorë përmbush vetëm 10 nga 16 indikatorë duke shënuar një nivel transparence më të ulët se viti i kaluar. Me vetëm gjysmën e indikatorëve të realizuar radhiten të parafundit Bashkia Elbasan dhe Kavajë. Ndërkohë, Bashkia me performancën më të dobët është Bashkia Fier niveli i transparencës së të cilës është vetëm 43.75%, duke shënuar një rënie të ndjeshme nga Indeksi i vitit të kaluar.

Sa u përket indikatorëve, vërehet se pothuajse të gjitha bashkitë e monitoruara e kanë publikuar

Programin e Transparencës në faqen e tyre të internetit, pa përjashtim. Ndërkohë, 8 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë caktuar dhe publikuar të dhënat për Koordinatorin për Konsultimin Publik, dhe 9 nga 10 kanë publikuar të dhënat e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.

Bashkitë kanë një performancë relativisht të mirë në konsultimin publik të Buxhetit Vjetor dhe në publikimin e tij në faqen e internetit. Në këtë mënyrë, 7 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë realizuar konsultime publike për hartimin e buxhetit dhe 8 nga 10 e kanë publikuar buxhetin vjetor. Performanca paraqitet më e dobët sa i përket konsultimeve publike për paketën e taksave dhe tarifave vendore ku 6 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë zhvilluar konsultime publike për këtë çështje.

Sa i përket transparencës së Këshillit Bashkiak, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë njoftuar datën dhe orën e Mbledhjes së Këshillit, Bashkiak. Vetëm 6 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Proces-Verbalet e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe nga ana tjetër, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Vendimet e Këshillit Bashkiak.

Transparenca mbetet relativisht e ulët sa i përket publikimit të Vendimeve dhe Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë. Vetëm 4 nga 10 bashkitë e monitoruara i kanë publikuar urdhërat apo vendimet e Kryetarit. Megjithatë kemi një rritje të lehtë krahasuar me vitin e kaluar, në të cilin vetëm 3 nga 10 bashkitë e plotësonin këtë indikator.

Nr	Bashkia	Indeksi i Transparencës
1	Bashkia Shkodër	100%
2	Bashkia Lezhë	100%
3	Bashkia Dibër	93.75%
4	Bashkia Durrës	93.75%
5	Bashkia Korçë	87.5%
6	Bashkia Sarandë	87.5%
7	Bashkia Vlorë	62.5%
8	Bashkia Elbasan	50%
9	Bashkia Kavajë	50%
10	Bashkia Fier	43.75%

MONITORIMI I PREMTIMEVE

Ekipi i Faktoje përzgjedhi katër premtime të bëra gjatë fushatës elektorale në zgjedhjet vendore Maj 2023 për secilën Bashki, si dhe premtime që lidhen me procesin e rindëtimimit për bashki të prekura nga tërmeti i viti 2019. Për monitorimin e këtyre premtimeve është ndjekur metodologjia e mëposhtme:

METODOLOGJIA

Premtimet për shërbimet publike mund të ndahen në dy grupe të mëdha:

- 1 Premtimet që lidhen me aktet administrative mbi uljen apo heqjen e taksave e tarifave apo për kthimin e një hapësire publike në pedonale, apo për hapjen e një qëndre sociale, kinemaje, etj.

Mbajtja e këtyre premtimeve realizohet përmes miratimit të akteve administrative ligjore si Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak. Disa prej këtyre premtimeve kanë edhe efekte financiare dhe për këtë duhet analizuar edhe buxheti për të parë nëse janë parashikuar fonde për ngritjen e një strukture të re;


- 2 Premtimet që lidhen kryesisht me infrastrukturën publike që përbëjnë detyrat dhe kompetencat kryesore të bashkive si ujësjellësi dhe kanalizimet, rrugët dhe hapësirat e gjelbërta, shkollat dhe kopshtet, qendrat shëndetësore, qendrat sociale dhe godinat e tjera publike, etj. Mbajtja e këtyre premtimeve lidhet ngushtësisht me buxhetin e bashkive.

Për të analizuar dhe dokumentuar mbajtjen e këtyre premtimeve fillimisht duhet parë nëse ato janë përfshirë në buxhetin e Bashkisë, më saktësisht në "Shpenzimet Kapitale" apo në "Shpenzimet e Mirëmbajtjes". Megjithatë, edhe nëse janë përfshirë në buxhet, nuk do të thotë se premtimet do të mbahen pasi bashkitë pothuajse gjithmonë nuk i përmbahen angazhimeve të buxhetit. Prandaj është me rëndësi që të shihet edhe nëse një bashki ka bërë ose planifikon të bëjë prokurimin publik për projektin në fjalë. Plani i prokurimeve mund të shihet në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlen të theksohet se realizimi i disa prej këtyre premtimeve mund të bëhen edhe në bashkëpunim apo me ndihmën e institucioneve të tjera, si Ministrinë e Linjës, psh, Ministria e Shëndetësisë për qendrat shëndetësore apo AKUM për ujësjellësat apo landfillet. Prandaj është e rëndësishme që të studiohen edhe buxhetet dhe prokurimet e këtyre institucioneve për të parë nëse e kanë përfshirë këtë projekt apo jo. Si rredhim, në bazën e të dhënave parashikohet të ekzistojë edhe seksioni "Institucion tjetër i përfshirë" për të identifikuar dhe monitoruar edhe këto institucione që mund të financojnë plotësisht apo bashkë-financojnë me bashkitë implementimin e këtyre projekteve.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Shërbimeve Publike, janë:

- 1 Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë;
- 2 Vendimet e Këshillit Bashkiak;



- 3 Buxheti;
- 4 Plani i Prokurimeve;
- 5 Lista e Kontratave të Shpallura;
- 6 Buxheti i Institucioneve të tjera të Përfshira dhe plani i tyre i prokurimeve.

Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Faktoje ndër morri hapat e mëposhtme:

- 1 Analiza e buxhetit të bashkive;
- 2 Analiza e Planit të Prokurimeve;
- 3 Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
- 4 Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.

PREMTIMET E MONITORUARA

Premtimet e përzgjedhura për secilën nga Bashkitë e përfshira në projekt janë si më poshtë.

BASHKIA DURRËS

- ◆ Rindërtimi i pallateve DS5 të lagjes nr. 5 në të njejtin vend.
- ◆ Ndërtimi i një godine parkimi publik në qendër të qytetit.
- ◆ Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për Fëmijë.
- ◆ Vijimësia me rikonstruksionin e 'Pallatit të Sportit

BASHKIA DIBËR

- ◆ Vaditja e 500 ha tokave bujqësore në Maqellarë.
- ◆ Asfaltimi i rrugës së Brestit të Sipërm.
- ◆ Takim me banorët në fshatin Rreth Kale të njësisë administrative Muhurr për punët e kryera dhe projektet e së ardhmes.
- ◆ Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës në Limjan e Vrenjt të njësisë administrative Kastriot.

BASHKIA SHKODËR

- ◆ Lirimi i hapësirave publike në sheshin Hafiz Sabri Koçi.
- ◆ Ndërtimi i një moli në hyrje të Shkodrës.
- ◆ Rijetëzimi i tregut Rus në Shkodër.
- ◆ Përfundimi i rrugës Shirokë – Zogaj – Kufi.

BASHKIA SARANDË

- ◆ Ndërtimi i një terminali model për autobusat interurbanë në hyrje të Sarandës.
- ◆ Përmirësimi urgjent i rrugëve dhe trafikut me ndërtimin e rrugës 6 dhe zgjatjen e shëtitores së qytetit deri te kanali i Çukës.
- ◆ Ndërtimi i 4 parkingjeve publike që lehtësojnë qëndrimin e turistëve në qytet.
- ◆ Shtimi i gjelbërimit, duke i imponuar çdo pallati një hapësirë gjelbërimi të detyrueshëm.

BASHKIA LEZHË


- ◆ Projekti për ndërtimin e një qendre të re për moshën e tretë.
- ◆ Sigurimi i ujit 24 orë për qytetarët e Lezhës.
- ◆ Rimbursimi i gjysmës së biletës së transportit urban për moshën e tretë dhe kategoritë e tjera në nevojë.
- ◆ Rindërtimi i pallatit 71 në lagjen 'Besëlidhja.

BASHKIA KORÇË

- ◆ Ndërtimi i një resorti skish në një nga zonat më të bukura malore të Korçës.
- ◆ Ndërtimi i Aeroportit të Korçës.
- ◆ Rehabilitimi i rrugës Lekas-Voskopojë.
- ◆ Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve. Janë rreth 2.5 km tubacione që do të shtrihen duke lidhur çdo banesë të Melçanit.

BASHKIA FIER

- ◆ Ndërtimi i një tregu bashkëkohor për tregtimin me shumicë të produkteve bujqësore.
- ◆ Ndërtimi i rrugës nga Manastiri i Ardenicës deri në Kishën e Shën Gjergjit në Libofshë.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- ◆ Rehabilitimi i qendrës së Libofshës, një zonë me resurse dhe mundësi të jashtëzakonshme në zhvillimin e turizmit.
- ◆ Investimi rrugor rural ka qenë një prioritet i punës së bashkisë, së bashku me pastrimin e kanaleve kulluese.

BASHKIA KAVAJË

- ◆ Ofrimi i bonuseve mujore në vlerën 50 mijë lekë në muaj për çdo lindje të re në Bashkinë Kavajë në vitin e parë të jetës“
- ◆ Zgjidhja përfundimtare e çështjes së ujit duke mundësuar furnizim 24 orë me ujë të pijshëm aq të rëndësishëm për banorët dhe turizmin.
- ◆ Kthimi i Parkut të madh të qytetit në një destinacion për familjen e madhe por edhe për vendet përreth.
- ◆ Pastrimi i qytetit të Kavajës

BASHKIA VLORË

- ◆ Ndërtimi i terminalit të autobusave në Vlorë.
- ◆ Krijimi i qendrës ditore për moshën e tretë në secilin rajon të qytetit si dhe ngritjen e një mense sociale bashkiake për shtresat në nevojë.
- ◆ Rikualifikimi total i tregjeve të qytetit, brenda dy viteve.
- ◆ Shtimi i koshave, hapësirave të dedikuara për grumbullimin e mbetjeve apo krijimin e fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese mbi pastërtinë e qytetit.

BASHKIA ELBASAN

- ◆ Rregullimi i pjesës së parë të rrugës ekzistuese drejt fshatit Funar.
- ◆ Pastrimi i përroit të Gurrës.

- ◆ Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare ‘Jonuz Çarçiu’ në fshatin Tregan dhe rikonstruksionin e shkollës ‘Naim Frashëri’ në qytetin e Elbasanit
- ◆ Ndërtimi i pikave të grumbullimit të prodhimit bujqësor në Shushicë, Bradashesh, dhe Gjergjan.

PROJEKTET E MËDHA

Projektet e mëdha përfshijnë projekte që kërkojnë një financim shumë të madh krahasuar me buxhetin e një bashkie e kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen dhe financimet e Qeverisë Qëndrore. Në këto projekte përfshihen Autostradat dhe Rrugët Kombëtare, Portet, Aeroportet dhe Terminale, Spitalet, Teatrot, Stadiumet, etj.

Këto projekte, pavarësisht se mund të jenë premtuar nga Kryebashkiakët, faktikisht janë jashtë kopetencave të Bashkisë. Por, premtimi i kryetarëve mund të lidhet edhe me lobimin pranë Qeverisë apo Ministrive për financimin e këtyre projekteve. Prandaj, për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve duhet të monitorohet buxheti dhe plani i prokurimeve i institucionit qëndror e jo i bashkisë.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Projekteve të Mëdha, janë:

- ◆ Buxheti i Institucioneve qëndrore në varësi të fushës, si psh. Ministrisë së Shëndetsisë për Spitalet, FSHF/MASR për Stadiumet, FSHZH apo ARRSH për rrugët, etj.

Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Fakteve ndërmorri hapat e mëposhtme:

- ◆ Analiza e buxhetit të bashkive;
- ◆ Analiza e Planit të Prokurimeve;
- ◆ Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
- ◆ Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE (PREMTIMET)

BASHKIA DURRËS


Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i pallateve DS5 të lagjes nr. 5 në të njëjtin vend.	Në këtë zonë ka përfunduar vetëm një pallat, ndërkohë që ende nuk ka nisur puna për rindërtimin e 8 të tjerëve.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i një godine parkimi publik në qendër të qytetit.	Godina e parkimit publik në qendër të qytetit të Durrësit nuk është ende funksionale, ndonëse kanë kaluar afatet për përfundimin e punimeve.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për Fëmijë.	Qendra Kulturore për Fëmijët në Durrës ka hapur dyert dhe ofron kurse falas për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, ndonëse ndërtimi i saj shkoj përtej afateve të parashikuara.	Premtim i mbajtur
Vijimësia me rikonstruksionin e 'Pallatit të Sportit	Në terren nuk ka nisur asnjë punim. Bashkia e Durrësit pohon se deri më tani ka në dorë projektin e realizuar, por nuk jep një ditë se kur mund të nisë rikonstruksioni.	Premtim i pambajtur

BASHKIA DIBËR

Premtimi	Komente	Statusi
Vaditja e 500 ha tokave bujqësore në Maqellarë.	Zyrtarisht, Bashkia Dibër sqaroi se projekti është akoma në fazën e hartimit.	Premtim i pambajtur
Asfaltimi i rrugës së Brestit të Sipërm.	Rruga rreth 1 km e Brestit të Sipërm në Dibër ende nuk është asfaltuar, pavarësisht premtimit të kryebashkiakut gjatë fushatës zgjedhore të një viti më parë.	Premtim i pambajtur
Rruga e fshatit Rreth Kale në Dibër	Rruga e fshatit Rreth Kale në Dibër ende nuk është asfaltuar.	Premtim i pambajtur
Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës në Limjan e Vrenjt të njësisë administrative Kastriot.	Rruga që lidh fshatrat Limjan e Vrenjt të njësisë administrative Kastriot në Dibër është asfaltuar, megjithëse investimi nuk është kryer nga Bashkia e Dibrës, por nga një kompani private.	Premtim i mbajtur

BASHKIA SHKODËR

Premtimi	Komente	Statusi
Lirimi i hapësirave publike në sheshin Hafiz Sabri Koçi.	Nisur nga informacionet e mbledhura dhe verifikimi në terren, trotualet u janë kthyer qytetarëve ndërsa për shitësit ambulantë janë sistemuar vendet përkatëse brenda tregut, por jo të gjithë e zbatojnë këtë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i një moli në hyrje të Shkodrës.	Punimet për molin e ri pranë urës së vjetër të Bunës kanë përfunduar.	Premtim i mbajtur
Rijetëzimi i tregut Rus në Shkodër.	Punimet për markatën e Rusit përfunduan përpara afatit zyrtar të kontratës. Tregu u hap më 15 dhjetor.	Premtim i mbajtur
Përfundimi i rrugës Shirokë – Zogaj – Kufi.	Nga verifikimet e fundit, në muajin tetor 2024 BERZH lidhi kontratën për fillimin e punimeve. Deri më 8 janar 2025 në terren po kryheshin punime për tre kilometrat e para të kësaj rruge.	Premtim pjesërisht i mbajtur



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA SARANDË


Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një terminali model për autobusat interurbanë në hyrje të Sarandës.	Terminali do të ndërohet në zonën e Qafë Gjashtës, dhe punimet kanë filluar, por janë në tejkalim afati për përfundimin e tyre.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Zgjatimi i shëtitorës së qytetit deri te kanali i Çukës.	Nga verifikimet në terren zgjatimi i shëtitorës drejt kanalit të Çukës duket i pamundur për shkak të mbingarkesës me ndërtesa anash rrugës. Bashkia informoi që ende nuk e ka një plan konkret për zgjatjen e shëtitorës së qytetit drejt kanalit të Çukës.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i 4 parkingjeve publike që lehtësojnë qëndrimin e turistëve në qytet.	Nga verifikimi në terren na rezultoi se nga katër parkingjet e premtuara, vetëm për një ka filluar ndërtimi, atij në hyrje të Ksamilit, por edhe aty nuk është vënë asnjë tabelë për të parë afatet e fillimit dhe mbylljes së punimeve.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Shtimi i gjelbërimit, duke i imponuar çdo pallati një hapësirë gjelbërimi të detyrueshëm.	Gjelbërimi nga verifikimet në terren është shtuar, por jo ajo para çdo pallati siç fillimisht u premtua.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA LEZHË

Premtimi	Komente	Statusi
Projekti për ndërtimin e një qendre të re për moshën e tretë.	Premtimi i kryebashkiakut Ndreu është pjesë e projekteve prioritare të Bashkisë Lezhë në buxhetin afatmesëm 2025-2027. Bashkia rindërtoi një garazh të amortizuar në lagjen Besëlidhja duke e shndërruar në një qendër ditore të frekuentuar nga të moshuarit lezhjanë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Sigurimi i ujit 24 orë për qytetarët e Lezhës.	Bashkia Lezhë po bashkëpunon me AKUK dhe institucionet e tjera për të siguruar ujë të pijshëm dhe pritshmëritë janë që brenda 2027 i gjithë territori të mbulohet me furnizim të ujit të pijshëm 24 orë në ditë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rimbursimi i gjysmës së biletës së transportit urban për moshën e tretë dhe kategoritë e tjera në nevojë.	Buxheti i Bashkisë Lezhë për këtë vit nuk ka asnjë para të planifikuar për rimbursimin e biletës së transportit urban për të moshuarit dhe kategoritë në nevojë. Madje, as programi buxhetor afatmesëm 2025 – 2027.	Premtim i pambajtur
Rindërtimi i pallatit 71 në lagjen 'Besëlidhja.	Pallati 71 në rrugën 'Luigj Gurakuqi' u shemb tre vite më parë, por nuk është rindërtuar. Bashkia e Lezhës është në pritje të financimit nga qeveria, ndërkohë që familjet e pastreha marrin bonusin e qirasë.	Premtim i pambajtur

BASHKIA KORÇË

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një resorti skish në një nga zonat më të bukura malore të Korçës.	Në një përgjigje zyrtare, Bashkia Korçë thotë se për shkak të madhësisë së projektit realizimi kërkon përfshirjen e disa aktorëve. Prandaj nuk është bërë deri më tani i mundur realizimi i këtij projekti.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i Aeroportit të Korçës.	Aeroporti po ndërohet në fshatin Lumalas 7.5 km larg qytetit juglindor. Vendi vijon të jetë i rrethuar nga një gardh me rrjetë dhe sipërfaqja e tokës ishte niveluar.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rehabilitimi i rrugës Lekas-Voskopojë.	Aktualisht, nga verifikimet në terren, gjendja e rrugës vazhdon të ngelet shumë e keqe. Po ashtu nga çakulli i hedhur rreth një vit më parë nuk ka asnjë gjurmë.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve. Janë rreth 2.5 km tubacione që do të shtrihen duke lidhur çdo banesë të Melçanit.	Punimet për kanalizimet e ujerave të ndotura përfunduan në tetor të vitit të kaluar. Por, banorët e fshatit ankohen se dhjetra shtëpi janë lënë jashtë projektit me vlerë 8,5 milionë lekë	Premtim pjesërisht i mbajtur




BASHKIA FIER

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një tregu bashkëkohor për tregtimin me shumicë të produkteve bujqësore.	Nga verifikimet e Faktoje.al në terren dhe nga përgjigja e Bashkisë Fier rezulton se qytetit të Fierit nuk i është shtuar tregu i premtuar.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i rrugës nga Manastiri i Ardenicës deri në Kishën e Shën Gjergjit në Libofshë.	Punimet për rikonstruksionin e rrugës që lidh Manastirin dhe Kishën ende nuk kanë nisur. Bashkia Fier u shpreh se ndërtimi i rrugës që lidh Manastirin e Ardenicës me Kishën e Shën Gjergjit kushhtëzohet nga "Rehabilitimi i qendrës së Libofshës" ndërkohë që FShZh thotë se ky projekt nuk ka lidhje me ndërtimin e rrugës së premtuar.	Premtim i pambajtur
Rehabilitimi i qendrës së Libofshës	Pas verifikimeve të Faktoje.al në terren rezulton se 18 muaj pas premtimit, punimet janë lënë përgjysmë duke krijuar vështirësi për banorët. Pedonales së sapondërtuar i janë shfaqur plasaritjet e para.	Premtim i pambajtur
Investimi rrugor rural ka qenë një prioritet i punës së bashkisë, së bashku me pastrimin e kanaleve kulluese.	Gjatë verifikimit në terren, rrugët e dy prej fshatrave të Njësisë Levani janë shtruar, por u mungon ndriçimi.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA KAVAJË

Premtimi	Komente	Statusi
Ofrimi i bonuseve mujore në vlerën 50 mijë lekë në muaj për çdo lindje të re në Bashkinë Kavajë në vitin e parë të jetës"	Bashkia e Kavajës ende nuk e jep bonusin mujor prej 5 mijë lekësh për bebat e sapolindura, një premtim i bërë nga kryebashkiaku gjatë fushatës për zgjedhjet vendore të 14 majit.	Premtim i pambajtur
Zgjidhja përfundimtare e çështjes së ujit duke mundësuar furnizim 24 orë me ujë të pijshëm fshatrat Rrakull dhe Karpen	Banorët e fshatrave Rrakull dhe Karpen në Kavajë nuk kanë ujë 24 orë. Ujësullësi i Durrësit bën të ditur për Faktoje.al se projekti është ende në fazën e hartim-projektimit, duke mos dhënë një datë kur pritet të nisnin punimet për projektin e premtuar.	Premtim i pambajtur
Kthimi i Parkut të madh të qytetit në një destinacion për familjen e madhe por edhe për vendet përreth.	Parku i Madh i Kavajës ka nisur transformimin, në park janë shtuar stola të rinj dhe kënde lojërash për fëmijë, ndërsa ishin mbjellë edhe pemë. Qytetarët e Kavajës shprehen të kënaqur për këtë investim, duke theksuar rëndësinë e mirëmbajtjes së vazhdueshme të parkut.	Premtim i mbajtur
Pastrimi i qytetit të Kavajës	Bashkia e Kavajës me një përgjigje zyrtare bëri të ditur se pastrimi i qytetit bëhet çdo ditë, pas orës 24:00, teksa pranojnë që ka ende probleme, kryesisht me mbetjet inerte.	Premtim pjesërisht i mbajtur



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA VLORË

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i terminalit të autobusave në Vlorë.	Nga verifikimet e Faktoje.al terminali interurban ende nuk ka nisur të ndërtohet. Bashkia thotë se ka përfunduar vetëm projektimin dhe se akoma nuk ka siguruar fondet për ndërtimin e tij.	Premtim i pambajtur
Krijimi i qendrës ditore për moshën e tretë në secilin rajon të qytetit si dhe ngritjen e një mense sociale bashkiake për shtresat në nevojë.	Ky premtim nuk është mbajtur nga ana e bashkisë Vlorë. Më shumë se një vit pas këtij premtimi, nuk është bërë asnjë hap përpara.	Premtim i pambajtur
Rikualifikimi total i tregjeve të qytetit, brenda dy viteve.	Nga verifikimet e 3 tregjeve të Vlorës, rezulton se nuk janë bërë ndryshime thelbësore në përmirësimin e kushteve të tregjeve ekzistuese.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Shtimi i koshave, hapësirave të dedikuara për grumbullimin e mbetjeve apo krijimin e fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere mbi pastërtinë e qytetit.	Një verifikim i kryer nga Faktoje.al, ka treguar se ky premtim nuk është realizuar plotësisht dhe se shtimi i kontenerëve është vetëm një pjesë e punës së kryer për pastrimin e qytetit.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA ELBASAN

Premtimi	Komente	Statusi
Rregullimi i pjesës së parë të rrugës ekzistuese drejt fshatit Funar.	Nga verifikimi i Faktoje.al në terren rezulton se rruga është shtuar vetëm në disa segmente të saj ndërsa Bashkia heq përgjegjësitë nga vetja.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i përroit të Gurrës.	Në fund të Shtatorit 2024, Faktoje vëzhgoi se përroi i Shushicës nuk ishte pastruar. Të dyja anët e tij ishin të mbushura me mbeturina, e njehta pamje si në verifikimin e fundit në terren.	Premtim i pambajtur
Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare 'Jonuz Çarçiu' në fshatin Tregan dhe rikonstruksionin e shkollës 'Naim Frashëri' në qytetin e Elbasanit	Për të katërtin vit radhazi, rikonstruksioni i shkollës "Naim Frashëri" nuk është përzgjedhur për financim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Bashkia Elbasan pohon se për shkollën "Jonuz Çarçiu" është në pritje të miratimit të lejes së ndërtimit që të niste zbatimin e projektit me vlerë 161 milionë lekë.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i pikave të grumbullimit të prodhimit bujqësor në Shushicë, Bradashesh, dhe Gjergjan.	Në Shushicë, Bradashesh dhe Gjergjan nuk ekzistonin pika grumbullimi. Në Qendrën e Rezervave të Shtetit në Shushicë, nuk dukeT se kishte filluar puna për ta transformuar atë në një pikë grumbullimi.	Premtim i pambajtur

ANALIZË KRAHASUESE (5 VJEÇARE)

Ky kapitull i dedikohet një analizë të thelluar krahasuese të performancës së bashkive përsa i përket transparencës dhe mbajtjes së premtimeve, bazuar mbi të dhënat e mbledhura nga raportimet e monitorimeve për pesë vitet e fundit (2019-2024). Raportet përkatëse janë hartuar duke përdorur metodologji analitike dhe standarte ligjore që matën zbatimin e indikatorëve kyç për transparencë dhe përfshirje publike, si dhe realizimin e premtimeve të kryebashkiakëve.

Analiza është ndërthurur me aspektet e mbajtjes së premtimeve të dhëna nga kryebashkiakët, duke analizuar qartësinë dhe zbatimin e angazhimeve të tyre dhe shqyrtimin e indikatorëve specifikë të transparencës, të cilët përfshijn publikimin e programit të transparencës, njoftimin dhe konsultimin publik të buxheteve dhe tarifave vendore, si dhe publikimin e


dokumenteve ligjore si procesverbalet e mbledhjeve të këshillit bashkiak dhe vendimeve të kryetarëve.

Rezultatet e kësaj analize do të evidentojnë ndryshimet e dukshme në performancën e bashkive për të identifikuar praktikatat më të mira dhe zonat ku nevojiten përmirësime të mëtejshme. Ky kapitull synon gjithashtu të shërbejë si një udhërrëfyes për politikëbërësit vendorë dhe organizatat monitoruese, duke ofruar rekomandime konkrete për përfortimin e qeverisjes lokale.

MBAJTJA E PREMTIMEVE

Mbajtja e premtimeve të kryebashkiakëve është një tregues i qenësishëm i qeverisjes së mirë dhe

2020	2021	2022	2023	2024
1. Shkodër	1. Shkodër	1. Shkodër	1. Shkodër	1. Shkodër
2. Lezhë	2. Lezhë	2. Lezhë	2. Lezhë	2. Lezhë
3. Korçë	3. Korçë	3. Durrës	3. Korçë	3. Korçë
4. Vlorë	4. Vlorë	4. Krujë	4. Vlorë	4. Vlorë
5. Elbasan	5. Elbasan	5. Vorë	5. Elbasan	5. Elbasan
6. Fier	6. Fier	6. Shijak	6. Fier	6. Fier
7. Patos	7. Durrës	7. Dibër	7. Durrës	7. Durrës
8. Kukës	8. Patos	8. Kurbin	8. Dibër	8. Dibër
9. Belsh	9. Kukës	9. Lushnje	9. Kavajë	9. Kavajë
10. Pustec	10. Belsh	10. Rrogozhinë	10. Himarë	10. Sarandë
	11. Pustec			
	12. Krujë			
	13. Vorë			
	14. Shijak			
	15. Kurbin			



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

përgjegjshmërisë publike. Po ashtu, ndjekja e premtimeve elektorale ka qenë një nga prioritetet e këtyre raporteve të përvitshme, të cilat si qëllim kanë pasur nxitjen e të gjitha bashkive për përmbushjen e tyre.

Gjatë këtyre viteve, monitorimi është fokusuar në dhjetë deri pesëmbëdhjetë bashki të përzgjedhura për çdo vit, duke përfshirë ato me sfida të veçanta në proceset e rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019 dhe ato që kanë zhvilluar zgjedhje të pjesshme vendore.. Në total pjesë e projektit janë bërë 21 bashki të listuara në tabelën e mëposhtme sipas vitit kur kanë qenë të monitoruara.

Pesë vitet e fundit, përveç vitit 2021 përgjatë të cilit janë monitoruar 15 bashki në total, çdo vit tjetër

bashkitë e monitoruara kanë qenë 10. Përzgjedhja e bashkive është bërë në bazë të sfidave specifike lokale apo domosdoshmërisë për rindërtim. Për secilën bashki janë identifikuar katër ose pesë premtime kryesore, të cilat janë vënë në monitorim për të vlerësuar realizimin e tyre. Premtimet e përzgjedhura i përkasin fushave si rindërtimi i infrastrukturës, përmirësimi i shërbimeve publike, dhe zhvillimi i ekonomisë lokale.

Premtimet kategorizohen si të mbajtura, të pambajtura dhe pjesërisht të mbajtura. Këto kategori ndihmojnë në vlerësimin e qartë të angazhimeve të marra nga kryebashkiakët dhe shkallës së realizimit të tyre. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e numrit të premtimeve të verifikuara për secilën bashki.

	Nr. i premtimeve të verifikuara	Të mbajtura	Pjesërisht të mbajtura	Të pambajtura
Shkodër	11	5	4	2
Lezhë	13	6	5	2
Korçë	7	1	3	3
Vlorë	8	1	3	4
Elbasan	8	1	1	6
Fier	8	1	2	5
Durrës	12	3	-	9
Patos	5	-	-	5
Kukës	4	-	-	4
Belsh	4	1	1	2
Pustec	4	-	1	3
Krujë	5	1	2	2
Vorë	7	1	1	5
Shijak	5	2	1	2
Dibër	7	4	-	3
Kurbin	7	1	1	5
Kavajë	4	1	1	2
Lushnje	4	1	2	1
Rrogozhinë	4	1	1	2
Sarandë	4	-	3	1
Himarë	4	-	2	2





FIGURA 1 - PARAQITJE GRAFIKE E NUMRIT TË PREMTIMEVE TË VERIFIKUARA



Bashkitë si Lezha, Shkodra, Durrësi, Elbasani dhe Fieri kanë numrin më të lartë të premtimeve të verifikuara për shkak se kanë qenë të monitoruara në pothuajse të 5 vitet e këtij projekti. ndërsa disa bashki si Lushnja, Rrogozhina, Saranda dhe Himara kanë numrin më të ulët (4) për shkak se janë monitoruar vetëm përgjatë një viti. Nëse bëjmë një analizë për secilën bashki vihet re se Lezha dhe Shkodra si 2 bashki të monitoruara çdo vit kanë përmbushur më shumë premtime se çdo bashki tjetër duke pasqyruar në këtë mënyrë edhe rëndësinë që ka pasur monitorimi dhe transparenca që ky projekt ka patur për qëllim në performancën e tyre.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA SHKODËR:


Shkodra ka rezultuar vazhdimisht si ndër bashkitë më të suksesshme në mbajtjen e premtimeve. Në nivel përqindjeje Bashkia ka përmbushur 45% të premtimeve dhe ka nisur punën për 36% të tyre duke lënë vetëm 20% të premtimeve të monitoruara të papambajtura.

- 2020** Të gjitha premtimet u monitoruan, dy prej tyre u mbajtën plotësisht (qendrat komunitare dhe banesat sociale për jetimët), ndërsa korsitë e biçikletave ishin pjesërisht të realizuara.
- 2021** Përmirësim; u raportua mbajtja e dy premtimeve plotësisht dhe një pjesërisht.
- 2022** Progres i qëndrueshëm; disa projekte të mëdha u finalizuan.
- 2023** Nisja e disa projekteve të rëndësishme si Tregu në lagjen Rus, Moli i ri dhe lirimi i hapësirave publike.
- 2024** 2 nga projektet e nisura një vit më parë (Tregu në lagjen Rus, Moli i ri) u finalizuan.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA LEZHË:

Bashkia Lezhë po ashtu me një performance të mire ka përmbushur 6 nga 13 premtimet e monitoruara gjatë 5 viteve, ka nisur punën për 5 prej tyre duke lënë vetëm 2 premtime të pambajtura.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- 2020** Realizim i pjesshëm i projekteve për ujin e pijshëm dhe infrastrukturën, ndërsa disa premtime mbetën në fazën e planifikimit.
- 2021** Performancë mesatare me disa përmirësime në projekte të vogla infrastrukturore. Trajtimi i mbetjeve mbeti sfidë e pazgjidhur, duke prekur drejtpërdrejt cilësinë e jetës në zonën urbane. Megjithatë 2 prej premtimeve të pambajtura të vitit 2020 u realizuan (Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme dhe Furnizimi me energji elektrike i Torovicës)
- 2022** Bashkia tregoi angazhim për promovimin e turizmit dhe përmirësime të pjesshme në infrastrukturën e qendrës së qytetit, por premtimet për transparencë dhe përfshirje qytetare u zbatuan vetëm pjesërisht.
- 2023** Angazhimi në rindërtim ishte më i dukshëm duke përbushur 2 premtime të tjera.
- 2024** Përmirësime në premtime që përfshijnë politikën sociale, siç është nisja për ndërtimin e një qendre të re për moshën e tretë.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA KORÇË:

Kjo bashki është monitoruar përgjatë viteve 2020, 2021, 2023, 2024 me një numër total prej 7 premtimesh të verifikuara prej të cilëve është përbushur 1 dhe ka nisur puna për 3 të tjerë.

- 2020** Rikonstruksioni i zonave si Ravonik ishte pjesërisht i realizuar, ndërsa projektet për pistat e skive mbetën të pambajtura.
- 2021** Premtimet kryesore si ndërtimi i muzeut të rakisë mbetën të pambajtura.
- 2023** Ende përqendrim i ulët në projektet e premtuara.
- 2024** Konsiderohet pjesërisht i mbajtur premtimi për ndërtimin e aeroportit të ri si dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA VLORË:

Bashkia Vlorë paraqet një performancë të dobët në mbajtjen e premtimeve. Mes 8 premtimeve të verifikuara në 4 vite, ka arritur të realizojë plotësisht vetëm 1 prej tyre.


- 2020** Bashkia arriti të përbushë pjesërisht premtimin për ndërtimin e banesave sociale, ndërsa premtimet për trajtimin e mbetjeve dhe furnizimin me ujë mbetën të pambajtura.
- 2021** Nuk u shënuar progres në rikonstruksionin e teatrit "Petro Marko", ndërsa projektet e lidhura me turizmin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore ishin të pjesshme dhe të kufizuara. U realizua vetëm ndërtimi i banesave sociale.
- 2023** Bashkia tregoi progres të kufizuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, ndërsa sfidat në financimin e projekteve mjedisore vazhduan të pengojnë përbushjen e objektivave.
- 2024** U shënuar progres i dukshëm në projektet bregdetare, veçanërisht në promovimin e turizmit dhe zhvillimin e zonës Lungomare, por nuk u dha asnjë zgjidhje në infrastrukturë për terminalin e autobusave.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA FIER:

Për Bashkinë Fier u monitoruan gjithsej 8 premtime në harkun e 4 viteve, nga të cilat pjesa më e madhe rezultojnë të pambajtura (5 nga 8).

- 2020** U shënuar progres i kufizuar në përmirësimin e infrastrukturës, ndërsa ndotja në lumin Gjanica vazhdoi të mbetet problem madhor. Ndërtimi i Pallatit të Kulturës nuk u realizua.
- 2021** Bashkia përbushi premtimin për rikonstruksionin e teatrit, por ndërtimi i terminalit të autobusëve mbeti në fazën



e planifikimit. Ndotja mjedisore, përfshirë lumin Gjanica, mbeti një sfidë e pazgjidhur

2023 Disa përmirësime të vogla në infrastrukturën sportive u arritën, por premtimet për bujqësinë dhe shërbimet urbane mbetën të papërbushura plotësisht. Ndotja në zonat urbane vazhdoi të jetë një problem i madh.

2024 Hapësirat rekreative u zgjeruan në disa zona të qytetit, por problemet mjedisore, veçanërisht ndotja e ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve, mbetën të pazgjidhura. Përmirësimet urbane ishin të kufizuara dhe nuk përmbushën pritshmëritë e qytetarëve.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA ELBASAN:

Kjo bashki përfshihet ndër ato me performancën më të dobët, ku nga 8 premtimet e verifikuara vetëm 6 rezultojnë ende të papambajtura.

2020 Përmirësime minimale u shënuan në menaxhimin e mbetjeve dhe reduktimin e ndotjes, ndërsa disa hapësira rekreative u zhvilluan në qytet. Premtimet për uljen e ndotjes nga industria mbetën të paplotësuara

2021 Sistemi i kanalizimeve u përmirësua në disa zona të qytetit, por ndikimi ishte i kufizuar. Projektet për pastrimin e ajrit mbetën në fazë të hershme planifikimi dhe nuk pati përfshirje të konsiderueshme në politikat për rininë.

2023 Bashkia u përpoq të adresojë menaxhimin e mbetjeve me projekte të vogla, por sfidat kryesore në infrastrukturën rrugore dhe transparencën mbetën të pazgjidhura. Qytetarët raportuan pak përmirësime në cilësinë e shërbimeve urbane.

2024 Hapësirat publike u përmirësuan në disa zona, por sistemi i riciklimit mbeti në planifikim dhe transporti publik vazhdoi të vuajë nga mungesa e investimeve të rëndësishme. Bashkia tregoi angazhim të pjesshëm në disa projekte, por pa ndikim të gjerë.

PËRMBLEDHJE PËR PREMTIMET

BASHKIA DURRËS:

Bashkia Durrës renditet e dyta për nga numri i premtimeve të verifikuara (12 të tilla). Por në shifra realizimesh vetëm 3 prej tyre rezultojnë të mbajtura.

2021 Fokusi kryesor ishte procesi i rindërtimit, i cili megjithëse u nis, mbeti prapa afateve të përcaktuara. Përmirësimet në infrastrukturë ishin të kufizuara, ndërsa strehimi social mbeti në fazën e planifikimit.

2022 U bë progres i kufizuar në menaxhimin e mbetjeve dhe zgjerimin e zonave rekreative. Problemet e trafikut urban mbetën një sfidë e madhe për qytetin, me ndikim minimal nga planet e ndërmarra.

2023 Disa projekte për zhvillimin e turizmit u vunë në zbatim, por mbrojtja e bregdetit dhe përmirësimi i shërbimeve publike vazhduan të përballen me mungesë fondesh dhe menaxhimi të dobët. Ndikimi i këtyre projekteve në cilësinë e jetës së qytetarëve ishte i kufizuar

2024 Procesi i rindërtimit vazhdoi me ritme të ngadalta, duke shkaktuar pakënaqësi të qytetarët. Përmirësimet në infrastrukturën rrugore u realizuan pjesërisht, ndërsa transparenca dhe përfshirja qytetare mbetën të dobëta.

INDEKSI I TRANSPARENCËS

Bashkitë të cilat janë bërë pjesë e Raportit të monitorimit nga viti 2019 deri në vitin 2024 kanë qenë 21 në total. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet indeksi i transparencës për secilën prej tyre bazuar në vitin kur është marrë në monitorim nga ky projekt. Nga tabela vërehet qartë se vetëm 2 nga bashkitë; Lezha dhe Shkodra kanë qenë të monitoruara gjatë gjithë 5 viteve të fundit.

Në grafikun 2 pasqyrohen vetëm bashkitë të cilat janë monitoruar për disa vite radhazi për të nxjerrë

në pah ndryshimet që kanë pasur, duke lënë jashtë vetëm 4 bashki të cilat janë monitoruar vetëm përgjatë një viti të cilat janë: Rrogozhina, Lushnja, Saranda dhe Himara. Nga grafiku shihet qartë se në pjesën më të madhe të rasteve, indeksi i transparencës ka qenë në rritje për secilën nga bashkitë, në rastet kur ato janë monitoruar për 2 vite ose më shumë radhazi. Përfundimisht bashkia Lezhë e cila ka pësuar një rënie nga viti 2020 në vitin 2021, për të shënuar më pas një rritje të nivelit të transparencës 100% në raportin

TABELA 1 - INDEKSI I TRANSPARENCËS SIPAS VITEVE PËR ÇDO BASHKI

		2020	2021	2022	2023	2024
1	Shkodër	93.3%	100%	100%	100%	100%
2	Korçë	86.6%	93.3%		100%	87.5%
3	Vlorë	86.6%	86.60%		75%	62.5%
4	Patos	80%	80%			
5	Kukës	60%	67%			
6	Lezhë	60%	53.3%	100%	100%	100%
7	Belsh	46.6%	80.00%			
8	Elbasan	46.6%	66.60%		62.5%	50%
9	Fier	40%	60%		68.7%	43.75%
10	Pustec	40%	53%			
11	Kurbín		13.3%	37.50%		
12	Krujë		66.6%	68.70%		
13	Vorë		60%	56.30%		
14	Durrës		73.3%	75%	81.2%	93.75%
15	Shijak		73.3%	93.70%		
16	Dibër			75%	87.5%	93.75%
17	Lushnje			50%		
18	Rrogozhinë			43.70%		
19	Sarandë					87.5%
20	Kavajë				18.7%	50%
21	Himarë				43.7%	






FIGURA 2 - INDEKSI I TRANSPARENÇES SIPAS VITEVE PËR ÇDO BASHKI.




e monitorimit të vitit 2022, 2023 dhe 2024. Po ashtu Bashkia Vorë ka pësuar një rënie me 3.7% të indeksit të transparencës nga viti 2022 (60%) në vitin 2023 (56.3%). Disa nga Bashkitë për të cilat evidentojmë përmirësime të dukshme në harkun kohor prej një

viti janë Bashkia Kavajë e cila vitin e kaluar plotëson vetëm 3 nga 16 indikatorët, ndërkohë në vitin 2024 plotëson 8 nga 16 duke e rritur nivelin e transparencës në 50%. Bashki të tjera me rritje relativisht të ndjeshme janë ato të Belshit dhe Kurbin.

FIGURA 3 - INDEKSI I TRANSPARENÇES BASHKIA SHKODËR






RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

FIGURA 4 - INDEKSI I TRANSPARENÇES BASHKIA LEZHË



Për sa i përket bashkive që kanë arritur të kenë nivelin më të lartë të transparencës, Bashkia Shkodër ka arritur 100 % të plotësisimit të indikatorëve për 4 vite radhazi.

Më poshtë po radhisim për çdo bashki, pikat më të forta të transparencës dhe ato më pak të tilla. Bashkia Lezhë dhe Korçë kanë qenë gjithashtu bashki të cilat përgjatë viteve të monitorimit të tyre kanë arritur nivelin e plotë të transparencës për indikatorët e matshëm. Më poshtë radhiten më shumë detaje për secilën nga Bashkitë që kanë qenë pjesë e projektit në këto 5 vitet e fundit.

1. BASHKIA SHKODËR

- 2020** Bashkia me performancën më të mirë me publikimin e programit të transparencës dhe pjesëmarrje të lartë në konsultime. (93.3%)
- 2021** Indeksi i transparencës ishte 100%, duke përbushur të gjithë indikatorët.
- 2022** Përmirësim i vazhdueshëm në publikimin e buxhetit dhe takimeve publike.

2023 Indeksi i transparencës ishte 100%, duke përbushur të gjithë indikatorët.

2024 Indeksi i transparencës ishte 100%, duke përbushur të gjithë indikatorët.

2. BASHKIA LEZHË

- 2020** Transparencë mesatare (60%), mungesa të theksuara në konsultimin publik.
- 2021** Indeksi shënon rënie (53.3%), problematika në publikimin e procesverbaleve dhe konsultimin për taksat.
- 2022** Përmirësim i ndjeshëm i transparencës, duke plotësuar të gjithë indikatorët e monitoruar.
- '23-'24** Ruan të njëjtin nivel transparence (100%)

3. BASHKIA KORÇË

- 2020** Publikim mesatar i informacionit, disa mungesa në njoftimin e mbledhjeve.
- 2021** Indeksi u rrit në masën 93.3%, duke përbushur shumicën e indikatorëve.
- 2023** Pas një viti të pa monitoruar, Bashkia





FIGURA 5 - INDEKSI I TRANSPARENÇES BASHKIA KORÇË



përmbush të gjithë indikatorët në vitin 2023


2024 Pëson rënie të nivelit të transparencës, probleme me publikimin e urdhrave të kryetarit të Bashkisë.


4. BASHKIA VLORË

2020 Problematika në publikimin e urdhërave të kryetarit dhe procesverbaleve.

2021 Indeksi ishte 86.6%. Mungesë transparence për vendimet e kryetarit.

FIGURA 6 - INDEKSI I TRANSPARENÇES BASHKIA VLORË






RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

FIGURA 7 - INDEKSI I TRANSPARENÇËS BASHKIA FIER



2023 Përmirësime të moderuara, por konsultimi publik ende i dobët.


2024 Rënie e ndjeshme e përmbushjes së indikatorëve duke plotësuar vetëm 10 nga 16.

5. BASHKIA FIER

2020 Një nga bashkitë me performancën më të ulët (40%).

2021 Përmirësim të nivelit të transparençës, ende shfaqen mungesa me publikimin e

FIGURA 8 - INDEKSI I TRANSPARENÇËS BASHKIA ELBASAN







FIGURA 9 - INDEKSI I TRANSPRENCËS BASHKIA DURRËS



buxhetit dhe të vendimeve të kryetarit.

- 2023** Përmirësime në publikimin e buxhetit, por indikatorët kryesorë ende problematikë.
- 2024** Përmirësime të dukshme, por konsultimi publik ende i dobët.

6. BASHKIA ELBASAN

- 2020** Transparencë mesatare, probleme në konsultimet publike.
- 2021** Niveli i transparencës rritet me 66.6%, me ngecje në publikimin e vendimeve.
- 2023** Ruan pothuajse të njëjtin nivel transparence si në vitin 2021.
- 2024** Nuk ka përmirësime të mëdha, niveli i transparencës pëson ulje. Probleme me konsultimin publik.

7. BASHKIA DURRËS

- 2020** Nuk ishte pjesë e monitorimit.
- 2021** Përfshirë për herë të parë; probleme të mëdha me transparencën pas tërmetit.
- 2022** Përmirësime në disa indikatorë, veçanërisht në publikimin e buxhetit.
- 2023** Rritje e nivelit të transparencës, mungesa në publikimin e vendimeve të kryetarit të Bashkisë dhe procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.
- 2024** Përmirësim i ndjeshëm i indikatorëve, ngelet të plotësohen emrat e koordinatorëve të konsultimit publik.

FONDI SOCIAL

Ofrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë dhe grupet vulnerabël është një domosdoshmëri për të garantuar një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Këto shërbime luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së individëve dhe familjeve që përballen me vështirësi ekonomike, sociale dhe shëndetësore, duke u ofruar atyre mbështetje konkrete për integrimin dhe mirëqenien e tyre.

Nëpërmjet financimit nga Fondi Social, bashkitë kanë mundësinë të identifikojnë dhe adresojnë nevojat specifike të komuniteteve, duke ofruar shërbime të personalizuar që mbështesin fëmijët në situatë rreziku, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit pa përkujdesje familjare, gratë e dhunuara dhe çdo grup tjetër që ka nevojë për mbështetje të specializuar.

Përmes këtij fondi, bashkitë kanë mundësinë të ngrejnë dhe të zhvillojnë shërbime të rëndësishme sociale, të sigurojnë mbrojtje për grupet vulnerabël dhe të garantojnë një nivel minimal shërbimesh të aksesueshme për komunitetin. Po ashtu, rritja e cilësisë dhe mbulimit të këtyre shërbimeve forcon besimin e qytetarëve tek institucionet dhe thekson rolin e bashkive si aktorë kyç në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale.

Në këtë kontekst, monitorimi dhe mbështetja e vazhdueshme e Fondit Social është thelbësore për të garantuar funksionimin efektiv të këtyre shërbimeve, duke u siguruar që mbështetja të arrijë realisht tek ata që kanë më shumë nevojë dhe që fondet të përdoren me transparencë dhe efikasitet në interes të komunitetit.


PËRFITUESIT E FONDIT SOCIAL

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:

- Familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
- Personat me aftësi të kufizuara;
- Të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- Vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;
- Të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në republikën e shqipërisë;
- Të moshuarit në nevojë.

PERFORMANCA E BASHKIVE

Qendra Faktoje me qëllim evidentimin e shumës së përfutuar nga Fondi Social si dhe periudhën e mbështetjes të 61 bashkive në vend 2023-2024, kërkoi informacion pranë bashkive, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave si dhe pranë Shërbimit Social Shtetëror. Nga 61 bashki, vetëm një bashki, ajo e Cërrikut nuk ju përgjigj kërkesës për informacion.




GJETJE DHE REKOMANDIME

Analiza e të dhënave ka nxjerrë në pah disa problematika të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe të strukturuar për të përmirësuar transparencën, koordinimin dhe qëndrueshmërinë e skemës së financimit.

- Një nga sfidat kryesore është mungesa e transparencës mbi ecurinë dhe zbatimin e Fondit Social. Asnjë prej institucioneve publike, qoftë në nivel qendror apo lokal, nuk ka publikuar të dhëna të detajuara mbi shpërndarjen dhe përdorimin e këtij fondi ndër vite. Kjo mungesë transparence krijon një boshllëk të konsiderueshëm në monitorimin e efektivitetit të fondit dhe vështirëson analizën mbi ndikimin e tij në përmirësimin e shërbimeve sociale. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të gjitha institucionet përfituese të publikojnë të dhëna të qarta dhe të aksesueshme nga publiku, duke përfshirë raportime të rregullta mbi përdorimin dhe rezultatet e fondit.
- Një tjetër problematikë e evidentuar është mungesa e një sistemi të mirëkoordinuar për raportimin dhe mbledhjen e të dhënave. Në shumë raste, raportimet e ndryshme të institucioneve përmbajnë mospërputhje që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e analizës dhe vështirësojnë monitorimin e ecurisë së fondit. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të krijohet një mekanizëm i unifikuar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, duke përfshirë një platformë të përbashkët ku të gjithë aktorët e përfshirë mund të kenë akses në informacion të përditësuar dhe të verifikuar.
- Një shqetësim tjetër lidhet me mungesën e planifikimit afatgjatë nga ana e bashkive për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale. Nga verifikimet e kryera, rezulton se asnjë bashki nuk ka parashikuar fonde në buxhetet e tyre afatmesme (2025-2027) për të vijuar mbajtjen në funksion të shërbimeve të financuara nga Fondi Social, pasi përfundon periudha e mbështetjes financiare. Kjo tregon një mungesë të angazhimit për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, duke vënë në rrezik vazhdimësinë e mbështetjes për qytetarët më në nevojë. Ky problem bëhet edhe më kritik për ato bashki që ndodhen tashmë në vitin e tretë të skemës së financimit 90%-60%-30%, të cilat duhet të kishin zhvilluar një plan të qartë për të siguruar burimet e nevojshme financiare për vijimësinë e shërbimeve.
- Një tjetër aspekt që kërkon sqarim është statusi i financimit të bashkive që ndodhen në vitin e katërt ose të pestë të zbatimit të Fondit Social. Meqenëse skema e financimit është konceptuar si një program trevjeçar, nuk është e qartë nëse fondet aktuale janë përdorur për vijimësinë e shërbimeve ekzistuese apo për krijimin e shërbimeve të reja. Për të shmangur paqartësitë dhe për të siguruar një kuptim më të saktë të situatës, është e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, së bashku me Ministrinë e Financave, të kryejnë një analizë të detajuar mbi financimin e këtyre bashkive dhe të përcaktojnë qartë perspektivën e mëtejshme të mbështetjes financiare.
- Përtej këtyre sfidave të menaxhimit dhe financimit, është gjithashtu e rëndësishme të vlerësohet kategoria e shërbimeve të ofruara nga bashkitë, duke siguruar që ato i përgjigjen realisht nevojave të komunitetit. Një proces i detajuar konsultimi me partnerët strategjikë dhe me përfaqësuesit e komunitetit është thelbësor për të identifikuar shërbimet që mungojnë dhe për të vendosur prioritetet për shërbimet e reja që duhet të krijohen. Kjo do të ndihmonte në hartimin e një plani më të saktë dhe më të përshtatshëm për zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor, duke u siguruar që Fondi Social të përdoret në mënyrë më efektive dhe me ndikim real për grupet në nevojë.

Fondi Social ka një rol thelbësor në sigurimin e mbrojtjes sociale dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve pjesë e grupeve vulnerabël dhe të



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

margjinalizuar. Për të garantuar një zbatim më të suksesshëm dhe me ndikim afatgjatë, është e domosdoshme të ndërmerren hapa të qartë për rritjen e transparencës, përmirësimin e koordinimit të raportimit, sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përshtatjen e shërbimeve me nevojat reale të komunitetit. Këto masa do të ndihmojnë në krijimin e një sistemi më efikas dhe të besueshëm të shërbimeve sociale, duke siguruar që askush të mos mbetet pa mbështetjen e nevojshme për shkak të mungesës së planifikimit dhe menaxhimit të duhur të Fondit Social.

ANALIZA E FINANCIMIT PËR FONDIN SOCIAL 2023-2024

VLERA E FINANCIMIT PËR FONDIN SOCIAL

Referuar informacionit të përcjellë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), u evidentua se për vitin 2023, vlera totale e financuar nga MSHMS për Fondin Social ishte 94,730,215 lekë, ndërsa për vitin 2024 ajo arriti në vlerën 133,079,987 lekë.

Por, pas analizës dhe përllogaritjes së kryer për secilën bashki përfituese, bazuar në të dhënat e raportuara nga MSHMS, u identifikua një mospërputhje mes vlerës totale të raportuar nga Ministria dhe shumës totale të financuar për secilën bashki për vitet 2023 dhe 2024.

Përkatësisht, për vitin 2023, shuma e financuar përllogaritet të jetë 84,866,879 lekë, ndërsa për vitin 2024, shuma e financuar përllogaritet 131,232,355 lekë.


Gjithashtu, sipas të dhënave të Shërbimit Social Shtetëror, shuma e financuar për vitin 2023 është 88,571,346 lekë, ndërsa për vitin 2024 ajo është 131,862,018 lekë.


Këto vlera nuk përputhen me vlerat e deklaruara nga MSHMS siç paraqitet edhe në grafikun më poshtë

BASHKIA VLORË


Viti 2023: Sipas MSHMS, financimi i akorduar është 3,971,724 Lekë, ndërkohë që sipas SHSSH është 6,278,524 Lekë. Diferenca prej 2,306,800 Lekë ngre nevojën për një shpjegim të qartë mbi bazën e raportimit të secilës palë.

FIGURA 10 - VLERA TOTALE PER FONDIN SOCIAL 2023-2024 (MLN LEKË)





Nr.	TE DHENAT REFERUAR MSHMS			TE DHENAT REFERUAR SHSSH		Viti aktual i Zbatimit te Fondit Social
	Bashkia	Vlera e financuar per vitin 2023	Vlera e financuar per vitin 2024	Vlera e financuar per vitin 2023	Vlera e financuar per vitin 2024	
1	Bashkia Durrës	3,536,784 Lekë	3,536,784 Lekë	3,536,784 Lekë	3,536,784 Lekë	5
2	Bashkia Fier	2,383,160 Lekë	3,093,403 Lekë	2,383,160 Lekë	3,093,403 Lekë	2
3	Bashkia Roskovec	1,156,050 Lekë	1,023,000 Lekë	1,156,050 Lekë	1,023,000 Lekë	3
4	Bashkia Kolonjë	3,523,152 Lekë	1,761,851 Lekë	3,523,152 Lekë	1,636,800 Lekë	3
5	Bashkia Selenicë	1,780,000 Lekë	2,328,000 Lekë	1,780,000 Lekë	2,328,000 Lekë	2
6	Bashkia Tepelenë	3,630,240 Lekë	1,940,240 Lekë	3,630,240 Lekë	1,940,240 Lekë	3
7	Bashkia Sarandë	4,124,972 Lekë	2,128,508 Lekë	4,124,972 Lekë	2,128,508 Lekë	3
8	Bashkia Delvinë	2,609,800 Lekë	1,206,368 Lekë	2,609,800 Lekë	1,206,368 Lekë	3
9	Bashkia Vlorë	3,971,724 Lekë	3,971,724 Lekë	6,278,524 Lekë	3,971,724 Lekë	4
10	Bashkia Gramsh	2,632,000 Lekë	3,210,000 Lekë	2,632,000 Lekë	3,210,000 Lekë	2
11	Bashkia Rrogozhinë	2,192,016 Lekë	2,192,016 Lekë	2,192,016 Lekë	2,192,016 Lekë	4
12	Bashkia Elbasan	1,715,945 Lekë	1,715,945 Lekë	1,715,945 Lekë	1,715,945 Lekë	4
13	Bashkia Klos	1,938,000 Lekë	2,258,000 Lekë	1,938,000 Lekë	2,258,000 Lekë	2
14	Bashkia Bulqizë	2,605,000 Lekë	2,605,000 Lekë	2,605,000 Lekë	2,550,000 Lekë	2
15	Bashkia Kukës	1,665,506 Lekë	1,665,506 Lekë	1,665,506 Lekë	1,665,506 Lekë	4
16	Bashkia Kamëz	4,368,903 Lekë	6,241,290 Lekë	4,368,903 Lekë	6,241,290 Lekë	2
17	Bashkia Berat	1,164,000 Lekë	1,164,000 Lekë	1,164,000 Lekë	1,164,000 Lekë	4
18	Bashkia Belsh	1,233,900 Lekë	1,233,900 Lekë	1,233,900 Lekë	1,233,900 Lekë	4
19	Bashkia Cërrik	1,576,974 Lekë	1,094,791 Lekë	1,576,974 Lekë	1,904,791 Lekë	2
20	Bashkia Maliq	1,618,348 Lekë	3,126,776 Lekë	1,618,348 Lekë	3,126,776 Lekë	2
21	Bashkia Pogradec	944,256 Lekë	1,144,324 Lekë	944,256 Lekë	1,144,324 Lekë	2
22	Bashkia Korcë	3,946,724 Lekë	3,946,724 Lekë	3,946,724 Lekë	3,946,724 Lekë	4
23	Bashkia Devoll	2,402,667 Lekë	1,572,750 Lekë	2,402,667 Lekë	1,572,464 Lekë	3
24	Bashkia Poliçan	2,653,952 Lekë	3,849,998 Lekë	2,653,952 Lekë	3,849,998 Lekë	2
25	Bashkia Librazhd	2,503,632 Lekë	2,503,632 Lekë	2,503,632 Lekë	2,503,632 Lekë	5
26	Bashkia Prrenjas	2,340,000 Lekë	2,340,000 Lekë	2,340,000 Lekë	2,340,000 Lekë	4
27	Bashkia Pukë	1,021,800 Lekë	2,455,200 Lekë	1,021,800 Lekë	2,455,200 Lekë	2
28	Bashkia Lezhë shërbimi 1	2,503,632 Lekë	1,172,000 Lekë	3,901,299 Lekë	3,901,299 Lekë	5
29	Bashkia Lezhë shërbimi 2	2,201,108 Lekë	2,729,299 Lekë	2,201,108 Lekë		2
30	Bashkia Shkodër	8,612,016 Lekë	4,158,672 Lekë	8,612,016 Lekë	4,158,672 Lekë	3
31	Bashkia Malësia e Madhe	1,830,000 Lekë	802,500 Lekë	1,830,000 Lekë	802,500 Lekë	3
32	Bashkia Patos	1,244,000 Lekë	2,895,000 Lekë	1,244,000 Lekë	2,895,000 Lekë	1
33	Bashkia Lushnje (2 sherbime)	1,249,600 Lekë	1,933,340 Lekë	1,249,600 Lekë	1,933,340 Lekë	1
34	Bashkia Gjirokastër	1,987,018 Lekë	4,779,857 Lekë	1,987,018 Lekë	4,779,857 Lekë	1
35	Bashkia Dimal		1,354,400 Lekë		1,354,400 Lekë	1



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

36	Bashkia Mat		5,368,050 Lekë		5,368,050 Lekë	1
37	Bashkia Vau Dejës		3,630,976 Lekë		3,630,976 Lekë	1
38	Bashkia Memaliaj		3,314,660 Lekë		3,314,660 Lekë	1
39	Bashkia Dropull		5,094,823 Lekë		5,094,823 Lekë	1
40	Bashkia Fushë Arrëz		4,069,700 Lekë		4,069,700 Lekë	1
41	Bashkia Dibër		4,515,000 Lekë		4,515,000 Lekë	1
42	Bashkia Libohovë		3,844,200 Lekë		3,844,200 Lekë	1
43	Bashkia Has		4,416,820 Lekë		4,416,820 Lekë	1
44	Bashkia Kurbín		2,498,000 Lekë		2,498,000 Lekë	1
45	Bashkia Këlcyrë		2,551,988 Lekë		2,551,988 Lekë	1
46	Bashkia Tiranë		6,793,340 Lekë		6,793,340 Lekë	1

BASHKIA LEZHË

Ofrohen dy shërbime të ndryshme në kuadër të Fondit Social, ku për shërbimin e parë viti 2023 janë konstatuar mospërputhje financiare:

SHËRBIMI I PARË:

Viti 2023: MSHMS raporton 2,503,632 Lekë, ndërsa SHSSH raporton 3,901,299 Lekë (diferencë prej 1,397,667 Lekë).

BASHKIA BULQIZË

Viti 2024: MSHMS raporton dy vlera të ndryshme financimi, 2,605,000 Lekë dhe 2,550,000 Lekë, pa ndonjë shpjegim mbi kategorizimin e tyre. SHSSH raporton vetëm 2,550,000 Lekë, duke ngritur nevojën për një sqarim mbi ndarjen e fondeve sipas llojit të shërbimeve të financuara.


BASHKIA KOLONJË

Viti 2024: MSHMS raporton një financim prej 1,761,851 Lekë, ndërsa SHSSH 1,636,800 Lekë, duke rezultuar në një diferencë prej 125,051 Lekë, e cila kërkon një verifikim të mëtejshëm.

Analiza e këtyre të dhënave tregon se ka mungesë harmonizimi midis raporteve të MSHMS dhe SHSSH sa i përket vlerave të financimit të Fondit Social për bashkitë. Mospërputhjet e identifikuara tregojnë për mungesë koherence në regjistrimin dhe raportimin e fondeve, duke ngritur shqetësime mbi transparencën dhe saktësinë e përdorimit të burimeve financiare publike.

Këto gjetje nënvizojnë nevojën për një proces të përmirësuar të monitorimit, ku institucionet përgjegjëse duhet të koordinojnë dhe të harmonizojnë të dhënat e tyre për të shmangur pasaktësitë dhe për të garantuar përdorimin e duhur të fondeve në funksion të shërbimeve sociale. Rekomandohet që MSHMS dhe SHSSH të ndërmarrin një rishikim të detajuar të vlerave të raportuara dhe të sigurojnë një mekanizëm të qartë dhe të verifikueshëm për shpërndarjen dhe monitorimin e fondeve të akorduara për bashkitë.

Në lidhje me shumat e akorduara për secilën prej bashkive përfituese të fondit social, e ndarë sipas viteve (2023/2024), më poshtë gjendet informacioni, i organizuar në formë tabelare ku përcaktohet bashkia, vlera e financuar për vitin 2023, vlera e financuar për vitin 2024 si dhe viti aktual i zbatimit të Fondit Social, sipas të dhënave të përcjella nga MSHMS dhe SHSSH.



VLERA E SHPENZUAR PËR FONDIN SOCIAL


Po sipas të dhënave të MSHMS, fondi i shpenzuar nga 40 institucione (33 bashki dhe 7 qarqe) për vitin 2023 është 176,293,132 lekë dhe fondi i planifikuar për vitin 2024, për 53 institucione (45 bashki dhe 8 qarqe) është 324,042,144 lekë. Ndërkohë Shërbimi Social Shtetëror raporton se, 34 bashki kanë nënshkruar marrëveshje si përfituese të Fondit Social në vitin 2023 dhe 45 bashki për vitin 2024. Ka një mospërputhje ndërmjet të dhënave të Ministrisë dhe SHSSH sa i përket numrit të bashkive përfituese për vitin 2023. Këto diferencë të dukshme mes të dhënave të raportuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror tregojnë pasaktësi në raportimet financiare dhe kërkojnë një rishikim të detajuar të të dhënave nga palët përkatëse. Ky proces është thelbësor për të siguruar transparencë dhe saktësi në evidentimin e shumave të përfituara nga bashkitë, duke garantuar që të gjitha të dhënat financiare të jenë të sakta dhe të përputhshme me realitetin.


SHËRBIMET E FINANCUARA SIPAS MSHMS

Përsa i përket shërbimeve të financuara për vitin 2023 dhe 2024, referuar informacionit të përcjellë nga MSHMS, rezulton se për vitin 2023 janë financuar 34 shërbime, nga këto, 22 shërbime që ka vijuar financimi nga vitet e mëparshme në bashkitë: Durrës, Lezhë, Librazhd, Prrenjas, Rroskovec, Berat, Korçë, Rogozhinë, Kukës, Elbasan, Vlorë, Belsh, Kolonjë, Tepelenë, Devoll, Delvinë, Shkodër, Malësi e Madhe, Sarandë, Lushnje, Gjirokastër, Patos dhe 12 shërbime të reja në bashkitë: Poliçan, Selenicë, Gramsh, Bulqizë, Klos, Maliq, Kamëz, Cërrik, Pukë, Pogradec, Lezhë, Fier.

Ndërsa për vitin 2024 janë financuar 49 shërbime, nga këto, 34 shërbime që ka vijuar financimi nga vitet e mëparshme në bashkitë: Durrës, Lezhë, Librazhd, Prrenjas, Rroskovec, Berat, Korçë, Rogozhinë, Kukës, Elbasan, Vlorë, Belsh, Kolonjë, Tepelenë, Devoll, Delvinë, Shkodër, Malësi e Madhe, Sarandë, Lushnje (2 shërbime), Gjirokastër, Poliçan, Selenicë, Gramsh, Bulqizë, Klos, Maliq, Kamëz, Cërrik, Pukë, Pogradec, Lezhë, Fier) dhe 15 shërbime të reja në bashkitë: Dimal, Mat, Vau Dejës, Memaliaj, Dropull, Fushë Arrëz, Dibër, Libohovë, Has, Kurbini, Këlcyre, Patos, Gjirokastër, Lushnje, Tiranë.

FIGURA 11 - SHËRBIME TOTAL PËR VITIN 2023 & 2024 (BASHKI PËRFITUESE)






RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

FIGURA 12 - VLERA E FINANCUAR PËR 10 BASHKITË NË MONITORIM PËR VITIN 2023 & 2024 (LEKË)



Të dhënat në grafikun 11 reflektojnë shumat e financuara për 10 bashkitë në monitorim si dhe vitin aktual të zbatimit, duke mos përfshirë bashkinë Kavajë pasi kjo bashki nuk rezulton të ketë qenë përfituese e Fondit Social për vitet 2023-2024.

PLAN VENDOR SOCIAL

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 111/2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social" përcakton që Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka kompetencën për të transferuar fonde tek njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore. Ky financim bazohet në planet sociale të buxhetuara nga bashkitë dhe të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë kontekst, për të qenë përfituese e Fondit Social, një bashki duhet të ketë një Plan Vendor Social të miratuar dhe të buxhetuar.


Bazuar në informacionin e përcjellë nga 60 bashki deri në tetor 2024, rezulton se 9 (nëntë) bashki nuk

kanë aktualisht një Plan Vendor Social të miratuar dhe në fuqi. Këto bashki janë:

- ◆ Bashkia Konispol
- ◆ Bashkia Libohovë
- ◆ Bashkia Malësi e Madhe
- ◆ Bashkia Pukë
- ◆ Bashkia Pustec
- ◆ Bashkia Rrogozhinë
- ◆ Bashkia Selenicë
- ◆ Bashkia Shkodër
- ◆ Bashkia Vau i Dejës

Bashkia Konispol është aktualisht në procesin e hartimit të Planit Vendor Social 2024-2027 dhe nuk ka qenë përfituese e Fondit Social as për vitin 2023 dhe as për vitin 2024.

Bashkia Pustec, Bashkia Rrogozhinë dhe Bashkia Vau i Dejës ndodhen në procesin e hartimit të Planit Vendor Social të ri.



Bashkia Selenicë është në fazën e finalizimit të Planit Vendor Social.

Bashkia Shkodër është në procesin e konsultimit të Planit të ri.

Nga analiza e mësipërme rezulton se një pjesë e bashkive ende nuk kanë përfunduar procesin e miratimit dhe buxhetimit të Planeve të tyre Vendore Sociale. Për të siguruar aksesin në financimin nëpërmjet Fondit Social dhe për të garantuar ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë, është e rëndësishme që këto bashki të përshpejtojnë procesin e hartimit, konsultimit dhe miratimit të Planeve të tyre Vendore Sociale. MSHMS duhet të monitorojë nga afër këtë proces dhe të ofrojë mbështetje teknike aty ku është e nevojshme për të përmbushur kriteret ligjore të financimit.


SHËRBIMET E OFRUARA NË 2024 SIPAS MSHMS

Për vitin 2024, Shërbimi Social Shtetëror raporton se kanë nënshkruar marrëveshje si përfituese të Fondit Social 45 bashki, dhe ofrohen 15 shërbime të reja në bashkitë: Dimal, Mat, Vau Dejës, Memaliaj, Dropull, Fushë Arrëz, Dibër, Libohovë, Has, Kurbin, Këlcyrë, Patos, Gjirokastrë, Lushnje, Tiranë.

Tabela e mëposhtme bazohet në të dhënat e 15 shërbimeve të reja të planifikuara për t'u ofruar në vitin 2024 nga bashki të ndryshme në vend. Përmes këtyre shërbimeve synohet mbështetja e disa kategorive të cënueshme të popullsisë, duke reflektuar prioritetet e politikave sociale për këtë vit.

TABELA 2 - SHËRBIMET E OFRUAR NË VITIN 2024 NGA BASHKI TË NDRYSHME NË VEND

Bashkia	Kategoria e përfituesve:	Tipologjia e shërbimit 2024
Bashkia Gjirokastrë	Viktima të Dhunës në Familje	Qendër emergjente për Viktimat e Dhunës
Bashkia Lushnjë	Të moshuar	Qendër ditore për të moshuar
Bashkia Mat	Fëmijë me aftësi të kufizuar	Shërbime mbështetese psiko-fizike për fëmijet me aftësi të kufizuar pranë qendrës ditore.
Bashkia Dimal	Familje, PAK, fëmijë, të moshuar	Qendër komunitare multifunksionale për shtresa më në nevojë.
Bashkia Tiranë	Të rinj, fëmijë PAK	Shërbime të integruara lëvizese biopsikosociale në njësitë administrative të zonave rurale
Bashkia Patos	PAK	Shërbim i specializuar
Bashkia Këlcyrë	Të moshuar	Qendër ditore për të moshuar
Bashkia Kurbin	Të moshuar	Qendër ditore për të moshuar
Bashkia Has	PAK	Shërbim komunitar i specializuar për persona me aftësi të kufizuar, përmes shërbimit lëvizës
Bashkia Libohovë	PAK dhe të moshuar	Shërbim lëvizës për moshën e tretë dhe PAK
Bashkia Dibër	PAK	Shërbim social lëvizës për fëmijë me PAK
Bashkia Dropull	PAK dhe të moshuar	Shërbim lëvizës dhe asistencë në familje për PAK dhe të moshuar.
Bashkia Fushë Arrëz	Familje, PAK, fëmijë, të moshuar	Qendër komunitare shumëdisiplinore për integrim socio - ekonomik.
Bashkia Memaliaj	Fëmijë	Qendra për shërbime mbrojtëse fuqizuese dhe emergjente për fëmijët dhe familjen.
Bashkia Vau i Dejës	Fëmijë me PAK	Shërbim Lëvizës në familje për fëmijët me AK.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- Shërbimet e reja për vitin 2024 janë më së shumti të përqendruara tek personat me aftësi të kufizuara (PAK), të cilët përfitojnë nga 9 prej tyre.
- Të moshuarit përfshihen në 6 prej shërbimeve të reja, duke reflektuar një vëmendje të veçantë për këtë grup demografik.
- Kategoritë e tjera, si fëmijët dhe familjet në nevojë, kanë mbështetje më të kufizuar në këtë grup të shërbimeve të reja.
- Asnjë nga shërbimet e reja të raportuara nuk është dedikuar posaçërisht viktimave të trafikimit apo të rinjve në konflikt me ligjin.

MOSPËRPUTHJE MES TË DHËNAVE TË INSTITUCIONEVE

Referuar të dhënave të raportuara nga 60 bashki, rezulton se 33 prej tyre kanë aplikuar për të përfituar nga Fondi Social në vitin 2024. Nga këto, vetëm 19 bashki janë shpallur fituese dhe kanë siguruar financim për ofrimin e shërbimeve sociale.

Bashkia Libohovë, në përgjigjen e saj zyrtare, konfirmon se nuk ka aplikuar për të përfituar nga Fondi Social për vitin 2024. Megjithatë, sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), kjo bashki është ndër 15 bashkitë që do të ofrojnë shërbime të reja gjatë vitit 2024. Për këtë qëllim, është miratuar një financim prej 3,844,200 lekësh përmes Fondit Social, dhe ky është viti i parë i zbatimit të tij në këtë bashki.

Gjithashtu, bashkitë Librazhd, Prrenjas, Pukë dhe Rrogozhinë, në përgjigjet e tyre zyrtare, kanë deklaruar se kanë aplikuar për Fondin Social të mundësuar nga MSHMS për vitin 2024 dhe janë shpallur fituese. Sipas të dhënave të MSHMS, këto bashki janë ndër ato që vijojnë të ofrojnë shërbime të financuara edhe nga vitet e mëparshme. Konkretisht:

- Bashkia Librazhd është në vitin e pestë të zbatimit të Fondit Social,
- Bashkia Prrenjas në vitin e katërt,

- Bashkia Pukë në vitin e dytë,
- Bashkia Rrogozhinë në vitin e katërt.

Referuar të dhënave mbi vlerën totale të financimit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për vitin 2023 dhe 2024 dhe destinacionin e përdorimit të fondeve në bashki, janë evidentuar disa mospërputhje midis deklaratave zyrtare të bashkive dhe të dhënave të MSHMS. Më konkretisht:

VITI 2023:

Bashkia Elbasan deklaroi në përgjigjen e saj zyrtare se fondi i përfituar nga Fondi Social në vitin 2023 ishte 4,343,945 lekë, ndërkohë që sipas të dhënave të MSHMS, vlera e akorduar ishte 1,715,945.16 lekë.

Bashkia Fier raportoi një fond të përfituar prej 9,431,288 lekësh, ndërsa sipas të dhënave të MSHMS, vlera e akorduar për këtë bashki në vitin 2023 ishte 2,383,160 lekë.


Bashkia Gjirokastrë deklaroi një financim prej 1,429,806 lekësh, ndërkohë që sipas të dhënave të MSHMS, vlera e akorduar ishte 1,987,018 lekë.

Bashkia Lezhë raportoi një fond të përfituar prej 8,703,080 lekësh, ndërsa sipas të dhënave të MSHMS, financimi për këtë bashki përfshin 12,503,632 lekë për shërbimin 1 dhe 22,201,108 lekë për shërbimin 2, me një total prej 4,704,740 lekësh, që gjithashtu nuk përputhet me shifrën e deklaruar nga bashkia.

Bashkia Librazhd deklaroi një fond të përfituar prej 7,510,896 lekësh, ndërkohë që sipas të dhënave të MSHMS, vlera e akorduar ishte 2,503,632 lekë.

Bashkia Malësi e Madhe raportoi një financim prej 1,802,500 lekësh, ndërsa sipas të dhënave të MSHMS, fondi i akorduar ishte 1,830,000 lekë.

Bashkia Patos deklaroi se nuk ka përfituar fonde nga Fondi Social për vitin 2023. Megjithatë, sipas të dhënave të MSHMS, kjo bashki ka përfituar 1,244,000 lekë.



Bashkia Selenicë deklaroi një fond të përfituar prej 17,489,600 lekësh, ndërsa sipas të dhënave të MSHMS, vlera e akorduar për këtë bashki ishte 1,780,000 lekë.

VITI 2024:

Bashkia Elbasan deklaroi në përgjigjen e saj zyrtare se vlera e financimit të miratuar nga MSHMS për vitin 2024 është 300 mijë euro. Megjithatë, sipas të dhënave të MSHMS, fondi i akorduar për këtë bashki për vitin 2024 është 1,715,945.16 lekë.

Bashkia Kolonjë raportoi një fond të miratuar prej 1,636,800 lekësh për vitin 2024. Kjo vlerë nuk përputhet me të dhënat e MSHMS, e cila konfirmon një financim prej 1,761,851 lekësh. Megjithatë, vlera e raportuar nga bashkia përputhet me të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH).

Bashkia Librazhd deklaroi një financim të miratuar nga MSHMS prej 7,510,896 lekësh për vitin 2024. Sipas të dhënave të MSHMS, fondi i akorduar për këtë bashki është 2,503,632 lekë, duke reflektuar një mospërputhje të konsiderueshme.

Bashkia Lushnjë konfirmon një financim të miratuar prej 2,895,000 lekësh, ndërkohë që sipas të dhënave të MSHMS, fondi i akorduar për vitin 2024 është 1,933,340 lekë.

Bashkia Patos raportoi një financim prej 1,933,340 lekësh, ndërsa të dhënat e MSHMS tregojnë se fondi i miratuar për këtë bashki për vitin 2024 është 2,895,000 lekë.

Këto mospërputhje ngrenë nevojën për një verifikim të mëtejshëm mbi procesin e raportimit dhe shpërndarjes së fondeve, duke siguruar një transparencë më të lartë në administrimin e financimeve të Fondit Social.

BUXHETI 2025 - 2027


Në lidhje me pyetjen nëse është parashikuar në buxhetin afatmesëm 2025-2027 një rritje e fondeve për të siguruar funksionimin e shërbimeve sociale edhe pas përfundimit të financimit nga Fondi Social, Ministria e Financave është përgjigjur se:

Sipas Shtojcave 4 dhe 5 të Udhëzimit nr. 3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", është përcaktuar një kod specifik produkti për bashkitë: "Shërbime sociale për grupet në nevojë të financuara nga Fondi Social". Kjo u mundëson bashkive që të planifikojnë fonde nga buxhetet e tyre për mbështetjen e shërbimeve sociale. Megjithatë, nga dokumentet e dorëzuara për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027 pranë Ministrisë së Financave, konstatohet se asnjë bashki nuk ka planifikuar fonde për këtë produkt, duke krijuar një boshllëk të mundshëm në financimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve sociale pas përfundimit të mbështetjes nga Fondi Social.

Nga ana tjetër, mbi gjysma e bashkive (36 bashki) kanë deklaruar se kanë parashikuar në buxhetin e tyre afatmesëm 2025-2027 fonde për të siguruar vijimësinë e shërbimeve sociale në territorin e tyre pas përfundimit të financimit nga Fondi Social. Kjo tregon një mungesë koherence midis planifikimit financiar dhe deklarimeve të bashkive, duke theksuar nevojën për një qasje më të strukturuar në integrimin e financimeve të shërbimeve sociale në buxhetet vendore afatmesme. Nga analiza e të dhënave të bashkive në lidhje me grupet vulnerabël që përfitojnë nga shërbimet sociale, vërehen disa trende dhe problematika të përbashkëta.

PËRMBLEDHJE E KATEGORIVE KRYESORE TË PËRFITUESVE

- 1 Të moshuarit dhe personat e vetmuar – Pothuajse të gjitha bashkitë raportojnë të moshuarit si kategori vulnerabël që ka nevojë për mbështetje, veçanërisht ata që janë të vetmuar ose pa përkrahje familjare.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- 2 Personat me aftësi të kufizuara – Një grup tjetër i madh që përfiton nga shërbimet sociale janë personat me aftësi të kufizuara, përfshirë të verbërit, invalidët e punës dhe personat me çrregullime të rënda fizike ose mendore.
- 3 Gratë dhe vajzat viktime të dhunës – Shumë bashki raportojnë si përfitues gra dhe vajza që janë viktime të dhunës në familje, shpeshherë duke përfshirë edhe viktimat e trafikimit.
- 4 Fëmijët dhe të rinjtë në nevojë – Përfshijnë fëmijët jetimë, ata në familje kujdestare, fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe fëmijët e braktisur ose në rrezik të lartë përjashtimi social.
- 5 Familjet në vështirësi ekonomike – Një kategori e gjerë që përfshin familjet pa të ardhura, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që kanë vështirësi të theksuara social-ekonomike.
- 6 Komuniteti Rom dhe Egjiptian – Ky komunitet raportohet si vulnerabël në disa bashki, duke përfshirë ata që jetojnë në kushte të rënda sociale dhe ekonomike.
- 7 Individë në situata të veçanta risku – Përfshin të pastrehët, personat me varësi nga substancat, emigrantët e kthyer me probleme sociale, dhe komuniteti LGBTI në disa bashki.

Disa bashki kanë një listë të gjerë kategorish që përfitojnë nga shërbimet sociale, ndërsa të tjera nuk raportojnë fare kategori vulnerabël ose kanë informacione të mangëta. Kjo sugjeron mungesë standardizimi në politikat e identifikimit dhe mbështetjes.

SHËRBIMET SOCIALE NUK MBULOJNË TË GJITHA NEVOJAT


Disa grupe vulnerabël, si individët me varësi nga substancat, viktimat e trafikimit, ose komuniteti LGBTI, nuk përmenden në shumicën e bashkive, gjë që tregon mungesë fokusimi tek nevojat e tyre specifike.

NEVOJA PËR POLITIKA MË TË QARTA DHE MBËSHTETJE MË TË RRJETËZUAR


Bashkitë me përqendrim më të madh në identifikimin e shtresave vulnerabël mund të shërbejnë si model për ato që kanë mungesë të qasjes së duhur ndaj këtyre grupeve. Nevojitet një sistem më i mirë i ndarjes së praktikave të mira dhe harmonizimit të politikave sociale në nivel vendor. Kjo analizë tregon se ka ende sfida në përfshirjen dhe mbështetjen efektive të grupeve vulnerabël në të gjitha bashkitë, duke theksuar nevojën për përmirësime në qasjen sociale dhe politikat e mbështetjes.

TABELA 3 - KATEGORITË E SHTRESAVE VULNERABËL TË IDENTIFIKUARA NË BASHKI QË MUND TË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMET SOCIALE.

Nr.	Bashkia	Kategoritë e shtresave vulnerabël të identifikuar në bashki që mund të përfitojnë nga shërbimet sociale.
1	Bashkia Belsh	Te moshuarit; Femijet me aftësi të kufizuara
2	Bashkia Berat	grate dhe vajzat e dhunuara; femijet ne nevojë për mbrojtje; komuniteti rom dhe egjiptian; familjet në vështirësi dhe nevojë për ndihmë socio-ekonomike; personat me aftësi të kufizuara; te pastrehet
3	Bashkia Bulqizë	Viktimat e dhunës në familje; Te moshuarit
4	Bashkia Cërrik	Ska pergjigje
5	Bashkia Delvinë	Të moshuarit; Personat me aftësi të kufizuara
6	Bashkia Devoll	Gra në nevojë për mbrojtje; Fëmijë dhe të rinj në situatë kritike; Të moshuar; Të pastrehët; Individë me AK dhe Invalidë pune; Individë në nevojë ekonomike; Të papunë; Romë dhe Egjiptianë
7	Bashkia Diber	Fëmijet me aftësi të kufizuara; Fëmijë në familje kujdestare; Femijë me status jetimi; Viktima të dhunës në familje; Të moshuar të vetmuar




8	Bashkia Dimal	Pakicat kombëtare; Gratë e dhunuara; Personat me aftësi ndryshe; Fëmijët në nevojë dhe mbrojtje; shtresa të tjera vulnerabël.
9	Bashkia Divjake	Invalidet e punës; Personat me Statusin e të verbërit; Paratetraplegjik; Personat me aftësi të kufizuara; Personat me Ndhmë Ekonomike, Familjet në nevojë (personat me status jetim, personat me urdhër mbrojtje, të moshuarit pensionist të vetëm; Gratë e dhunuara, vajzat e dhunuara mbi 18 vjeç, burrat e dhunuar me moshë madhore; Komuniteti Rom+Egjiptian; personat madhore me probleme të shëndetit mendor.
10	Bashkia Dropull	PAK, të verbër, paratetraplegjikë, invalidë, pensionistë të vetmuar, fëmijë autikë, persona në varësi nga alkoli, persona të braktisur nga familjet
11	Bashkia Durres	Fëmijë në situatë për mbrojtje, gra të dhunuara, fëmijë me aftësi të kufizuara, moshë e tretë, komuniteti rom dhe egjiptian, persona nga komunitete LGBTI, individë në situatë përjashtimi dhe rreziku, viktimat e mundshme të trafikimit dhe të trafikimit.
12	Bashkia Elbasan	Moshë e tretë, Pakica Etnike, Gra të dhunuara, Fëmijë, Aftësi e Kufizuar, Komuniteti LGBT
13	Bashkia Fier	Familjet në nevojë dhe pa burim të ardhurash, të moshuarit e vetmuar, fëmijët me aftësi ndryshe të moshës 6 - 19 vjeç, fëmijet dhe të rinjtë e familjeve në nevojë dhe të komunitetit rom e egjiptian, të miturit dhe gratë viktimat të dhunës në familje, viktimat të abuzimeve seksuale, individët në situatë emergjente rruge, rrezik trafikimi apo trafikimi, fëmijë pa kujdes prindëror apo situatë shfrytëzimi.
14	Bashkia Finiq	Të moshuarit e vetmuar, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, viktimat e dhunës në familje
15	Bashkia Fushë-Arrëz	Individet mbi 18 vjeç të regjistruar si përfitues të ndihmës ekonomike; individet punëkerkues; invalidet e punës; personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç; të rinjtë; të rriturit me probleme sociale për shkak të varferise përfitues të ndihmës ekonomike; grate me probleme shëndetësore; grate viktimat të dhunës dhe trafikimit; emigrantet e kthyer me probleme.
16	Bashkia Gjirokastër	Nuk ka informacion specifik
17	Bashkia Gramsh	Moshë e tretë; të rinjtë, viktimat e dhunës në familje; familjet në nevojë; personat me aftësi të kufizuara
18	Bashkia Has	Të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët në vështirësi ekonomike
19	Bashkia Himarë	Njerëzit në nevojë, fëmijët dhe të rinjtë, vajzat dhe gratë viktimat të mbijetuara të dhunës në marrëdhënie familjare.
20	Bashkia Kamëz	Familjet në nevojë; Fëmijët në nevojë për mbrojtje; Viktimat e dhunës në familje; Personat me aftësi të kufizuara; Komuniteti Rom dhe Egjiptian.
21	Bashkia Kavajë	Familjet me të ardhura të ulëta; Personat me aftësi të kufizuara; Komunitetet e pakicave etnike, si komuniteti Rom dhe Egjiptian; Fëmijët pa kujdes prindëror; Gratë dhe vajzat në situatë të vështira.
22	Bashkia Këlcyrë	Pensionistet e braktisur ose të vetmuar, personat me aftësi ndryshe dhe invalidët.
23	Bashkia Klos	Të moshuarit e mbetur vetem; personat me aftësi të kufizuara; gratë/vajzat; fëmijët në nevojë për mbrojtje; familjet në nevojë
24	Bashkia Kolonjë	Moshë e tretë, personat me aftësi ndryshe
25	Bashkia Konispol	Nuk ka asnjë kategori vulnerabël
26	Bashkia Korçë	Familje që kanë fëmijë të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë (pavarësisht arsyeve që kanë sjellë ndarjen e fëmijës); familje që janë në rrezik për institucionalizimin e fëmijëve të tyre; familje me vështirësi të theksuara në ushtrimin e prindërimit që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës dhe dinamikave familjare; familje me marrëdhënie konfliktuale, duke përfshirë familje të divorcuara, me një prind, kryefamiljare nëna, nëna-vajza, apo në kushtet e një humbje të madhe në familje, etj; familje me anëtarë me probleme të shëndetit mendor apo fizik, përdorimit dhe abuzimit me lëndë alkoolike/narkotike, aftësisë ndryshe; familje kujdestare (profesionale) në nevojë për të përballuar përshtatjen me fëmijën apo menaxhimin e sjelljeve të tij/saj probleme të theksuara prindërimi që mund të ndikojnë dhe/ose në zhvillimin e fëmijës. Familje në vështirësi social-ekonomike.
27	Bashkia Krujë	Familjet e ndihmës ekonomike; personat me aftësi të kufizuara; grate e dhunuara; komuniteti rom dhe egjiptian; të moshuarit e vetmuar; invalide pune; fëmijet jetime; fëmijet me aftësi ndryshe; të verbërit; paratetraplegjikët;



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

28	Bashkia Kuçovë	Persona me probleme shendetesore; te braktisurit; persona me PAK; viktimat e dhunes; femije ne situatë rruge
29	Bashkia Kukës	Femijet me aftësi të kufizuar; Të moshuarit; viktimat e dhunes
30	Bashkia Kurbin	Gratë e dhunuara, femije të rritur me AK, femije ne nevoje per mbrojtje dhe rrezik, familje pa të ardhura dhe ne nevoje, familje me NE
31	Bashkia Lezhë	Femijet; të moshuarit; personat me aftësi të kufizuar; viktimat e dhunes ne familje dhe trafikimit; personat ne nevoje per ndihme ekonomike; te pastrehet; komuniteti rom dhe egjyptian; komuniteti LGBTI; te rinjte
32	Bashkia Libohovë	Te moshuarit dhe personat me AK
33	Bashkia Librazhd	Personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, komuniteti egjyptian, femijet jetim grate e dhunuara
34	Bashkia Lushnjë	Të moshuarit; gratë e divorcuara dhe të veja; vajzat nëna; viktimat e dhunës në familje; femijet e braktisur; personat me PAK; familjet në kushte të vështira social-ekonomike.
35	Bashkia Malësi e Madhe	Personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe gratë e dhunuara
36	Bashkia Maliq	Gratë e dhunuara; femijet; familjet nga shtresat vulnerabël; të moshuarit; personat me aftësi të kufizuar
37	Bashkia Mallakastër	Janë familjet në nevojë; personat që trajtohen me pagesë PAK.
38	Bashkia Mat	Fëmijët në situatë risku; Personat me aftësi të kufizuara; Të moshuarit pa përkrahje; Familjet dhe individët që jetojnë në varfëri; Gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje; Të rinjtë pa mbështetje ekonomike ose në rrezik të lartë përjashtimi social
39	Bashkia Memaliaj	Familjet në nevojë; gratë e dhunuara; femijet viktimat të dhunës në familje; të moshuarit
40	Bashkia Mirditë	Personat që trajtohen me ndihmë ekonomike; aftësi e kufizuar; invalid pune; femijet me status jetimi; viktimat e dhunës në familje; femijet në kujdestari në një familje kujdestare; te moshuarit mbi 100 vjeç; të pastrehët.
41	Bashkia Patos	Personat me aftësi të kufizuar, familjet më të ardhura të pakta ose aspak, gratë viktimat të dhunës, të miturit e familjeve në nevojë dhe jo vetëm, të moshuarit
42	Bashkia Peqin	Personat me aftësi ndryshe; të moshuarit
43	Bashkia Përmet	Të moshuar të vetmuar; persona apo femijë me aftësi të kufizuar; gra të dhunuara; komuniteti egjyptian; familjet e pastreha; femijë në situatë rruge; persona në vështirësi ekonomike.
44	Bashkia Pogradec	PAK, para dhe tetraplegjike, të moshuar në nevojë dhe të vetmuar, shërbime për femijet dhe gratë e dhunuara, komuniteti rom dhe egjyptian.
45	Bashkia Poliçan	Familjet në nevojë pa të ardhura, persona me AK, të moshuar të braktisur, të moshuar të vetmuar, persona mbi 50 vjeç te vetmuar, persona të raportuar si raste dhune, status jetim.
46	Bashkia Prrenjas	Persona me aftësi të kufizuara; familjet me ndihmë ekonomike; jetimët, familjet me gra kryefamiljare; gratë e dhunuara; të moshuarit e vetëm; komuniteti rom dhe egjyptian.
47	Bashkia Pukë	Gratë e dhunuara; gratë e divorcuara, jetimët; pensionistet e vetmuar.
48	Bashkia Pustec	Familjet që përfitojnë nga Ndhima Ekonomike
49	Bashkia Roskovec	Fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuar; Gra, të mbijetuara të dhunës në familje; Familje në nevojë dhe me ndihmë ekonomike; Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe asistence psiko-sociale apo shërbime të tjera referuese; femijë dhe të rinj në konflikt me ligjin; Të moshuar të vetmuar dhe në nevojë.
50	Bashkia Rrogozhinë	Të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, familjet me të ardhura të ulëta, femijet dhe të rinjtë, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe komunitetet rom dhe egjyptiane.
51	Bashkia Sarandë	Fëmijë pa kujdes prindëror; Qendra polivalente e të moshuarve; Familje në ndihmë ekonomike; Persona me aftësi të kufizuar
52	Bashkia Selenicë	Egjyptianët, gra kryefamiljare, familjet në nevojë, jetimët, femijë në kujdestari, pensionist të vetmuar
53	Bashkia Shijak	Familje në nevojë; femijë në nevojë për mbrojtje; femijë PAK; gra të dhunuara; të moshuar të vetmuar.



54	Bashkia Shkodër	Fëmijët që gëzojnë mbrojtje; PAK; të rriturit me probleme sociale; viktimat e dhunës në familje, të trafikimit; varësisë ndaj drogës dhe alkoolit; vajza shtatzëna ose prindi i vetëm me një fëmijë deri në 1 vjeç; të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin; të moshuarit në nevojë
55	Bashkia Skrapar	Të moshuar në nevojë, familje me NE dhe PAK, fëmijë me PAK
56	Bashkia Tepelenë	Të moshuar të vetmuar dhe në nevojë, fëmijë me aftësi ndryshe; gratë e dhunuara; gratë kryefamiljare.
57	Bashkia Tiranë	Familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtjen; personat me aftësi të kufizuara; të rriturit me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit; vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën; të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin; të moshuarit në nevojë.
58	Bashkia Tropojë	Familje ekstremisht të varfra; gra të dhunuara; fëmijë në situatë rruge; persona me aftësi ndryshe; mosha e tretë e vetmuar.
59	Bashkia Vau Dejës	Fëmijë me aftësi të kufizuara
60	Bashkia Vlorë	Qendër ditore komunitare për personat me aftësi të kufizuara dhe qendër ditore për të moshuarit dhe për shtresat në nevojë.
61	Bashkia Vorë	Persona të prekur me sëmundje të rëndë

Ky raport u mbështet nga National Endowment Democracy (NED)

Raporti u punua nga: Erta Marku dhe Erisa Proko

